



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



RAPORT VJETOR

JANAR – DHJETOR 2022

Mars 2023

AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT (APK)

RAPORT VJETOR

JANAR – DHJETOR 2022

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK), është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për parandalimin e korrupsionit në Kosovë, paraqet Raportin vjetor të punës për periudhën 01 janar-31 dhjetor 2022 në Kuvendin e Republikës së Kosovës, përkatësisht Komisionit Parlamentar për Legjislacion Mandate dhe mbikëqyrje të Agjencisë Kundër Korrupsionit, sikurse është përcaktuar me nenin 15 të Ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Raporti vjetor i Agjencisë, mbulon periudhën 1 janar deri 31 dhjetor 2022 dhe paraqet në mënyrë kronologjike realizimin e aktiviteteve të bazuara në planin e performancës së vitit 2022, krahasime me vitet e kaluara dhe analiza lidhur veprimet e parandalimit të korrupsionit që ka të bëjë me zbatimin e kornizës ligjore kundër korrupsionit.

PËRMBAJTJA

PËRMbledhje Ekzekutive	5
LISTA E SHKURTESAVE.....	7
PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I AGJENCISË, KORNIZA LIGJORE DHE ORGANIZIMI I BRENDSHËM, BUXHETI, PERSONELI DHE PROKURIMI	8
KORNIZA LIGJORE.....	8
ORGANIZIMI I BRENDSHËM	9
BUXHETI	10
ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA).....	11
PERSONELI.....	11
PROKURIMI	11
MENAXHIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE	12
TË DHËNA STATISTIKORE LIDHUR ME GJENDJEN E PARANDALIMIT TË KORRUPSIONIT QË KA TË BËJË ME KOMPETENCAT E AGJENCISË	12
PROCEDURA ADMINISTRATIVE E HETIMEVE PARAPRAKE	12
TRAJTIMI I RASTEVE PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT	13
DEKLARIMI DHE KONTROLLI I PASURISË.....	14
PARANDALIMI I KORRUPSIONIT NË PROKURIMIN PUBLIK	16
LLOGARIDHËNIA, DHE KOMUNIKIMI ME MEDIA.....	17
TRAJTIMI I RASTEVE TË SINJALIZIMIT.....	18
ZBATIMI I KORNIZËS LEGJISLATIVE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE PËRMIRËSIMIN E KORNIZËS LIGJORE EKZISTUESE KUNDËR KORRUPSIONIT	19
RASTET E REFERUARA NË AUTORITETET E ZBATIMIT TË LIGJIT DHE GJYQËSORE.....	21
INFORMATA STATISTIKORE PËR SHKARKIMET NGA PUNA, HETIMET, AKTAKUZAT DHE VENDIMET NË LIDHJE ME RASTET E REFERUARA NGA AGJENCIA.....	22
AKTAKUZAT DHE VENDIMET NË LIDHJE ME RASTET E REFERUARA NGA AGJENCIA	23
PËRFAQËSIMI I RASTEVE NË GJYKATA	26
DEKLARIMI, ORIGJINA DHE KONTROLLI I PASURISË SË ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIK, PËRFSHIRË INFORMATA STATISTIKORE, KRAHASIME ME VITET E MËPARSHME DHE ANALIZA	26
KONTROLLI I DEKLARIMIT TË PASURISË.....	29
PRANIMI I DHURATAVE NË LIDHJE ME KRYERJEN E DETYRËS ZYRTARE	30
KONTROLLI I DHURATAVE.....	30
PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT NË EKZEKUTIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE, PËRFSHIRË INFORMATA STATISTIKORE, KRAHASIME ME VITET E MËPARSHME DHE ANALIZA	30
PARANDALIMI I KORRUPSIONIT NË PROKURIM PUBLIK DHE MONITORIMI	33

VLERËSIMI I RREZIKUT DHE I AKTEVE LIGJORE KUNDËR KORRUPSION	33
PLANET E INTEGRITETIT	34
BASHKËPUNIMIN ME INSTITUCIONET VENDORE	34
BASHKËPUNIMIN ME ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE DHE INSTITUCIONE TË HUAJA.....	36
BASHKËPUNIMI RAJONAL	36
AKTIVITETET E AGJENCISË NË ORGANIZIMET PËR SHKËMBIM TË PËRVOJA DHE BASHKËPUNIM RAJONAL	37
AKTIVITETET MEDIATIKE	39
AKTIVITETET E VETËDIJESIMIT TË PUBLIKUT.....	41
KËRKESAT PËR QASJE NË INFORMATA PUBLIKE	43
MËSIMET E NXJERRA DHE PRIORITETET NË TË ARDHMEN	44
RAPORT LIDHUR ME TRAJTIMIN E RASTEVE TË SINJALIZIMIT TË JASHTËM	46
RAPORTET VJETORE NGA INSTITUCIONET PUBLIKE, SUBJEKTET PRIVATE, SI DHE RREGULLATORËT LIDHUR ME SINJALIZIMIN, 01 JANAR -31 DHJETOR 2022	48
PUBLIKIMI I EMRIT TË ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR PRANIMIN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË SINJALIZIMIT.....	48
SHTOJCA NR. 1. ORGANOGRAMI I AGJENCISË PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT (APK)	50
SHTOJCA NR.2. LISTA E PJESËMARRJES NË TRAJNIME, FORUME, SEMINARE GJATË VITIT 2022	51

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti vjetor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për periudhën raportuese janar- dhjetor 2022, prezanton të arriturat dhe përpjekjet e Agjencisë me udhëheqjen dhe qasjen e lidershit të ri të Agjencisë i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 24 dhjetor 2021 dhe angazhimin maksimal të 43 punonjësve të Agjencisë, përfshirë sfidat dhe përparësitë që e kanë karakterizuar institucionin.

Agjencia ka filluar vitin si Agjenci Kundër Korrupsion dhe pjesën e dytë të vitit e ka vazhduar si Agjenci për Parandalimin e Korrupsionit, si rezultat i ndryshmit të ligjit themelor të saj. Ky raport është përgatitur në përputhje me kornizën raportuese të përcaktuar me ligjin e ri të Agjencisë.

Gjatë vitit 2022, Agjencia ka vazhduar punën dhe aktivitetet e saja në mënyrë të planifikuar dhe sistematike në parandalimin e korrupsionit, konfliktin e interesit, mbrojtjen e sinjalizuesve, organizmin dhe menaxhimin e procesit të deklarimit të pasurisë dhe dhuratave dhe parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik me rezultate konkrete, dukshëm më të larta të krahasuar me vitet paraprake.

Gjatë periudhës raportuese janar- dhjetor 2022, Agjencia ka ushtruar fushë veprimtarinë e saj në mënyrë objektive dhe profesionale, duke trajtuar numër të konsiderueshëm të kërkesave të adresuara nga institucionet publike, raportimet anonime, raportime dhe kërkesa të adresuara nga mediat dhe shoqëria civile dhe grupe të tjera të interesit për të cilat u ofruan përgjigje, opinione, këshilla dhe vendime, varësisht nga natyra e rasteve të trajtuara.

Përveç kësaj Agjencia ka ofruar përkrahje përmes ekspertizës profesionale sipas kërkesës nga institucione publike për hartimin e rregullave të brendshme për parandalimin e korrupsionit, varësisht nga kërkesat e institucioneve. Puna e Agjencisë besojmë që ka kontribuar pozitivisht në përmirësimin e rangimit të Kosovës në raport me parandalimin e korrupsionit dhe luftimit të tij në raporte kredibile ndërkombëtare.

Si rezultat i rritjes së dinamikës së veprimeve të Agjencisë, transparencës dhe politikës së dyerve të hapura për parandalimin dhe luftimin e Korrupsionit shënoi rritje edhe numri i raportimeve dhe kërkesave dhe rezultoi të përfundojë me dyfishin e rasteve të trajtuara në krahasim më dy vitet e mëparshme dhe vetëm në procedurë paraprake të hetimeve administrative në periudhën raportuese janar- dhjetor 2022, Agjencia trajtoi gjithsej 619 raste. Për trajtim në mënyrë ex-officio u iniciuan 415 ndërsa u proceduan 276 kallëzime penale në Zyrën e Kryeprokurorit Shtetit për procedim të mëtutjeshëm.

Në veprimet ligjore dhe aktivitetet për parandalimin e konfliktit të interesit dhe kufizimeve në ushtrimin e funksioneve publike, në vitin 2022, Agjencia rriti dinamikën e trajtimit të rasteve me 100% dhe në diferencën e trajtimit të rasteve, krahasuar me dy vitet paraprake trajtoi gjithsej 233 raste. Të njëjtën dinamikë në performancë, Agjencia e tregoi dhe në veprimet për parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik dhe gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, ku Agjencia trajtoi 218 raste dhe shumica dërmuese rezultuan me ndërmarrjen e veprime konkrete nga institucionet përkitazi me rekomandimet dhe opinionet e APK-së.

Ngritja e standardeve të komunikimit dhe llogaridhënies në Agjenci, besojmë që ndikoi në ndërgjegjësimin e zyrtarëve të lartë publik me ndërmarrjen e veprimeve për respektimin të detyrimeve ligjore për deklarimin e pasurisë dhe në krahasimin me vitet paraprake numri i zyrtarëve që e deklaruan pasurinë ndryshoi nga 97.77% sa ishte në vitin 2021, një rritje e përgjegjësisë u shënuar në vitin 2022 dhe kërkesës ligjore për deklarimin e pasurisë iu përgjigjen 98.72% të subjekteve deklaruese. Situatë e ngjashme u

paraqit edhe në deklarimin e pasurisë me rastin e marrjes së detyrës dhe përfundimit të detyrës zyrtare ku llogaridhënia e zyrtarëve publik u rrit dukshëm krahasuar me vitet paraprake.

Krijimi i standardeve të reja të forcimit të transparencës së Agjencisë, ndikoi që në periudhën raportuese janar-dhjetor 2022, numri i aktiviteteve të komunikimit publik të shënoj dyfishin e veprimeve të krahasuar me vitet paraprake dhe krijoi një situatë të re të ngritjes së besimit të qytetarëve për të raportuar raste të keqpërdorimit të mundshëm të detyrës zyrtare.

Qasja pro aktive dhe bashkëpunimi me media që aplikoi Agjencia në vitin 2022, dhe krijimi i klimës së partneritetit me media dhe Organizata Jo –Qeveritare, ndryshoi trendin e komunikimit me media në krahasim me vitet e mëparshme dhe ndikoi dukshëm që numri i kërkesave të mediave për të siguruar informata nga Agjencia të dyfishohet në krahasim me vitet pasuese. Nga gjithsej 177 kërkesa të adresuara nga subjekte të ndryshme, në periudhën raportuese janar-dhjetor 2022, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në kuadër të komunikimit publik, nga numri total i përgjigjeve, Agjencia ofroi 156 përgjigje për mediat, 17 përgjigje për Organizatat Jo-Qeveritare dhe 3 përgjigje për studentë.

Përpjekjet e lidershit të ri Agjencisë për intensifikimin e aktiviteteve për bashkëpunim rajonal mundësuan që përmes iniciativave rajonale, Agjencia të përfitojë përvoja të reja në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit nëpërmjet pjesëmarrjes në forume rajonale, projekteve për ngritjen e kapaciteteve në fushën e mbrojtës së sinjalizuesve, parandalimit të konfliktit të interesit dhe projekte për forcimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve.

Përkushtimi i Agjencisë për të ngritur në standard më të lartë llogaridhënien dhe komunikimin publik përkitazi me respektimin e legjislacionit për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë, rezultoi që më 12 dhjetor 2022, për herë të parë nga themelimi i saj, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) të marr mirënjohje nga Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ), në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE), çmimin “Për praktikën më të mirë në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve” dhe u shpërblye si institucioni me performancën më të mirë në zbatimin dhe promovimin e dy gjuhëve zyrtare në Kosovë.

Bazuar në përgjegjësitë dhe obligimet ligjore të Agjencisë të përcaktuara Ligjin nr.08/l-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencia ka ndërmarrë veprime përgatitore për zbatimin e obligimeve të reja ligjore që burojnë nga legjislacioni i ri për deklarimin elektronik të pasurisë, vlerësimin kundër-korrupsion të akteve ligjore dhe planet e integritetit të cilat veprime janë paraqitur në raport në detaje në formë kronologjike.

LISTA E SHKURTESAVE

APK Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit
AKK Agjencia Kundër Korrupsionit
AKP Agjencia Kosovare e Pronës
ARBK Agjencia për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës
ARC Agjencia e Regjistrimit Civil
BE Bashkimi Europian
DSAK - Departamenti Special Anti-Korrupsion
DHKEK Drejtoria për Hetimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, Policia
NjIF Njësia e Inteligjencës Financiare
GJK Gjykata Kushtetuese G
JTH Gjykata Themelore
IKAP Instituti Kosovar për Administratë Publike
IPK Inspektorati Policor i Kosovës
KEK Korporata Energjetike e Kosovës
KGJK Këshilli Gjyqësor i Kosovës KPK Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPPK Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
KQZ Komisioni Qendror Zgjedhor
KRPP Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LDC Leadership and Development Consultancy
MAP Ministria e Administratës Publike
MASHT Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MD Ministria e Drejtësisë
MDA Menagment Development Association
MFT Ministria e Financave dhe Transfereve
MFSK Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MMPH Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB Ministria e Punëve të Brendshme
MSH Ministria e Shëndetësisë MTI Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NJPMNP Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
OE Operator Ekonomik
OSBE Organizata për Siguri dhe bashkëpunim në Evropë
OSHP Organi Shqyrtues i Prokurimit PK Policia e Kosovës
PPK Prokuroria Publike Komunale
PPQ Prokuroria Publike e Qarkut
PSRK Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PSH Prokuroria e Shtetit PTH Prokuroria Themelore
QKSPEZH Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim
RAI Regional Anti-Corruption Initiative
SPV Strategjia dhe Plani i Veprimit Agjencisë kundër Korrupsionit
TI - Transparency International
UNDP - United Nations Development Program
UP - Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” ZKM Zyra e Kryeministrit
ZMBI -Zyra për Marrëdhënie, Bashkëpunim

PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I AGJENCISË, KORNIZA LIGJORE DHE ORGANIZIMI I BRENDSHËM, BUXHETI, PERSONELI DHE PROKURIMI

KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit u plotësua në vitin 2022 me miratimin e dy ligjeve që rregullojnë fushë veprimtarinë e saj: Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit si dhe Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave i cili ka hyrë në fuqi me datë 21 korrik 2022, ndryshoi dhe plotësoi të mandatin ligjor të Agjencisë, duke shtuar kompetenca të reja si: Monitorimi i zbatimit të Planeve të Integritetit, Vlerësimi i Rrezikut nga Korrupsioni si dhe Vlerësimi i akteve ligjore kundër korrupsionit, komponentë këto të cilat hyjnë në zbatim gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Sa i përket Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave Ligji, i cili u miratua me datë 10 gusht 2022, dhe hyn në fuqi gjashtë (6) muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare, më saktësisht me datë 10 shkurt 2023, plotësim ndryshimet e ligjit karakterizohen me zgjerimin e listës së zyrtarëve publik të cilët do t'i nënshtrohen procesit të deklarimit të pasurisë si: mjekët e licencuar që ushtrojnë veprimtari në institucionet publike (niveli dytësor dhe terciar), profesorët e Universiteteve Publike, zyrtarët doganorë etj, të cilat kategori do t'i nënshtrohen këtij obligimi ligjor një (1) vit nga hyrja në fuqi e Ligjit. Një nga kompetencat e shtuara është: shqiptimi i gjobave nga Agjencia ndaj subjekteve deklaruese, zyrtarëve kontaktues të institucioneve, në rast të mos përmbushjes me kohë dhe konform obligimeve ligjore për deklarimin e pasurisë, si dhe deklarimi i pasurisë përmes sistemit elektronik.

Ligji për Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit ka rregulluar statusin, mënyrën e organizmit dhe kompetencat Agjencisë për Parandalimin Korrupsionit si në vijim:

- Zbatimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave dhe Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve që përfshijnë: Mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit dhe marrjen e masave të parapara me ligjin e veçantë; Mbikëqyrjen e deklarimit të pasurive; dhe Mbikëqyrjen e pranimit të dhuratave që lidhen me kryerjen e detyrës zyrtare dhe ndërmarrjen e masave të parapara me ligj;
- Dhënien e mendimeve lidhur me konfliktin e interesit dhe mbikëqyrjen e dhuratave që lidhen me kryerjen e detyrës zyrtare;
- Mbikëqyrjen dhe marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e sinjalizuesve.
- Ndërmarrjen e veprimeve në fushën e monitorimit të planit të veprimit të strategjisë nacionale kundër korrupsionit, vlerësimit kundër- korrupsion të akteve ligjore, vlerësimeve të rrezikut të korrupsionit dhe planeve të integritetit që përfshijnë:
 - Dhënien e ndihmës profesionale dhe teknike, këshilla dhe mbështetje të iniciativave të cilat synohen të ndërmerren nga institucionet për parandalim të korrupsionit;
 - Dhënien e rekomandimeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës mbi vlerësimin e projektligjeve që lidhen me parandalimin e korrupsionit kur kjo kërkohet nga këto institucione apo me vendim të Drejtorit të Agjencisë;
 - Monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe planit të saj të veprimit;
 - Bashkëpunimin me institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile për vetëdijesimin e publikut për parandalimin e korrupsionit;
 - Zhvillimin dhe mbikëqyrjen e vlerësimit të rrezikut të korrupsionit dhe Dhënien e opinioneve lidhur me aktet ligjore për qëllim të përafrimit me standardet ndërkombëtare kundër korrupsionit;

- Monitorimin e zbatimit të planit të integritetit të institucioneve publike;
- Kryerjen e hetimeve administrative dhe ndërmarrjen e veprimeve në rastet që bien në kuadër të kompetencave të Agjencisë; Referimin e kallëzimeve penale në prokurorinë e shtetit ose në rast të shkeljes administrative përcjelljen e rastit tek organi administrativ kompetent
- Inicimin e procedurave kundërvajtësve nga fushë veprimtaria e vet në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi dhe Shqiptimi i gjobave dhe ndërmarrjen e masave tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Organizimi i brendshëm i Agjencisë është i rregulluar me Rregulloren Nr. 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Rregullores Nr. 01/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe ka të punësuar 43 zyrtarë, ndërsa struktura organizative e Agjencisë, përbehet nga departamentet dhe divizionet:

1. Departamenti për Luftimin e Korrupsionit është përgjegjës për zhvillimin e procedurave të hetimit paraprak të rasteve të dyshimit për korrupsion, analizimin e të dhënave statistikore dhe të dhënave të tjera për gjendjen e korrupsionit në Kosovë, hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, mbrojtjen e sinjalizuesve sipas Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve si dhe raportimin për zbatimin e detyrave të Agjencisë të përcaktuara nga dokumentet tjera strategjike. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Hetime dhe Analiza, 2. Divizioni për Hetime dhe Strategji, dhe 3. Divizioni për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

2. Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit është përgjegjës për mbikëqyrjen e pasurisë, mbikëqyrjen e dhuratave dhe parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik dhe korrupsionit në tërësi. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Deklarimin e Pasurisë dhe Dhuratave dhe 2. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik.

3. Departamenti për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë publik gjatë ushtrimit të funksionit publik, bashkëpunon me Autoritetet Përgjegjëse, merret me analizimin dhe trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, pranon raportet vjetore nga Autoritetet Përgjegjëse, ofron asistencë profesionale dhe këshilla për institucionet tjera në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për Zyrtarë të Lartë dhe Autoritete Përgjegjëse, dhe 2. Divizioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për Autoritete Përgjegjëse dhe Personat Zyrtarë.

4. Departamenti për Financa dhe Punë të Përgjithshme është përgjegjës për menaxhimin dhe përkujdesjen për burimet materiale, ofrimin e shërbimeve administrative, menaxhimin e financave dhe buxhetit si dhe logjistikën e Agjencisë. Ky Departament është i përbërë nga Divizioni për Shërbime të Përgjithshme, Buxhet dhe Financa.

5. Zyra për Mbështetje Profesionale dhe Bashkëpunim është përgjegjës për ofrimin e mbështetjes profesionale, për menaxhimin dhe administrimin e të dhënave elektronike të agjencisë dhe të sistemit të TI-së, dhe çështjet tekniko-administrative dhe arkivimin e shkresave zyrtare.

6. Koordinator i Zyrës për Komunikim me publikun organizon, koordinon, drejton dhe bashkërendon aktivitetet lidhur me informimin e publikut dhe mediave përkitazi me punën, aktivitetet dhe veprimtarinë e Agjencisë.

7. Menaxheri i personelit dhe Menaxheri Prokurimit përgjegjës për proceduat e rekrutimit, për menaxhimin e disa aktiviteteve të prokurimit.

(Shtojca 1. Organogrami i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit)

BUXHETI

Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit të Agjencisë në shumën prej 545,778.00 €u realizua sipas obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe kërkesat për fonde sipas kategorive ekonomike, u adresuan sipas nevojave reale të institucionit. Tabela në vazhdim pasqyron buxhetin fillestar i aprovuar me Ligjin për buxhet, sipas kategorive ekonomike, buxhetin final , shpenzimet të shprehur edhe ne % të realizimit .

Nr	Kategoritë ekonomike	Buxheti i aprovuar (fillestar)	Buxheti final Pas rishikimit	Shpenzimet	% e realizimi bazuar ne buxhetin fillestar	% e realizimit bazuar ne buxhetin final
		A	b	c	d=(c÷ a)	e=(c÷b)
1	Paga dhe Shtesa	413,222.00	413,222.00	413,201.12	99.9	99.9
2	Mallra dhe Shërbime	114,056.00	114,056.00	112,242.13	98.4	98.4
3	Shpenzime Komunale	8,500.00	3,500.00	3,196.47	37.6	91.3
4	Investimet kapitale	10,000.00	8,216.00	7,273.92	72.7	88.53
	Totali	545,778.00	538,973.12	535,913.64	98.19%	99.43%

Alokimi i fondeve është bërë në bazë të Planit të Rrjedhës së Parasë, të përgatitur nga Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në bashkëpunim me zyrtarin e prokurimit dhe Drejtorin e Agjencisë dhe Buxheti i aprovuar me ligjin për buxhet dhe ka plotësuar nevojat Agjencisë në realizimin e të gjitha obligimeve financiare. Nga buxheti fillestar prej 545,778.00 €, për të gjitha kategoritë, janë shpenzuar në total prej 535,913.64 €, apo shprehur përqindje 98.19%. dhe bazuar në dinamikën e ulët të ekzekutimit të buxhetit në kategorinë e Shpenzimeve Komunale, sipas kërkesës së Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve për evidentimin e kursimeve të mundshme janë deklaruar si mjete të lira në kategoritë: Shërbime komunale 5,000.00 €; Investime kapitale 1,784.00€; Gjithsej 6,784.00 €.

Paga dhe Shtesa -Ndarjet fillestare në kategorinë e Paga dhe Shtesa kanë qenë 413,222.00 €, ndërsa janë shpenzuar në vlerën prej 413,201.12 €, në përqindje 99.9 %, ndërsa në Mallra dhe Shërbime- Ndarjet fillestare në kategorinë e Mallra dhe Shërbime kanë qenë 114,056.00€, nga kjo shumë janë shpenzuar 112,242.13 €, në përqindje 98.4 %. Shpenzime Komunale - Ndarjet fillestare në kategorinë Shpenzime Komunale kanë qenë në shumën prej 8,500.00 €, ndërsa buxheti final ka qenë 3,500.00€. Nga buxheti final janë shpenzuar gjithsej 3,196.47 €, në përqindje 91.3%, mjete të shpenzuara për pagesën e telefonisë fikse. Shpenzimet për mirëmbajtjen teknike të ndërtesës, rrymën elektrike, ujin, mbeturinat dhe parkingu, janë mbuluar nga MPBAP. Ndërsa, Investimet Kapitale - Ndarjet fillestare në kategorinë investime kapitale kanë qenë në shumën prej 10,000.00€, ndërsa buxheti final ka qenë 8,216.00€ nga buxheti final janë shpenzuar 7,273.92 €, shprehur në përqindje 88.53 %.

Tabela në vijim pasqyron ndarjen buxhetore sipas kategorive ekonomike dhe shpenzimeve në dy vitet e fundit.

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti final për vitin 2020	Shpenzimet 2020	Buxheti final për vitin 2021	Shpenzimet 2021	Buxheti final për vitin 2022	Shpenzimet 2022
		-	-	a	b	c	d
1	Paga dhe Shtesa	406,582.86	406,582.86	389,901.46	389,901.46	413,222.00	413,201.12
2	Mallra dhe Shërbime	88,377.63	58,232.70	39,617.83	39,454.66	114,056.00	112,242.13
3	Shpenzime Komunale	3,375.57	2,788.69	2,320.96	2,320.96	3,500.00	3,196.47
4	Investimet kapitale	-	-	-	-	8,216.00	7,273.92
	Totali	498,336.07	467,604.25	431,840.25	431,677.08	538,994.00	535,913.64

ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)

Me rastin e kontrollit financiar për vitin 2022, vlerësimi i përgjithshëm për pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale kanë pasur prezantim të drejtë dhe të vërtetë. Në Raportin e Auditimit për PVF të APK-së, është dhënë një rekomandim: 1. Prezantim jo i drejtë i pasurive nën 1,000.00€ në PFV.

Ky rekomandim adresohet për shkak të mos funksionimit të sistemit të e-pasuria që është nën menaxhimin e MPBAP. Ky rekomandim është adresuar dhe pas rregullimit të sistemit nga ministria përgjegjëse sistemi është funksional dhe janë regjistruar pasuritë nën vlerën 1,000.00€ .

PERSONELI

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka të punësuar 43 zyrtarë, ndërsa 2 zyrtarë janë në pushim pa pagesë, pozita të pezulluara konform Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik. Në kuadër të planit të rekrutimit janë zhvilluar procedurat e rekrutimit dhe janë zgjedhur dy pozita: Menaxher i prokurimit dhe Asistent ekzekutiv i Drejtorit të Agjencisë. Në kuadër të obligimeve ligjore është themeluar Komisioni Disiplinor që nuk ka pranuar asnjë kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore gjatë vitit 2022. Bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore është zbatuar dhe monitoruar plani për ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të Agjencisë.

(Shih Shtojca 2, Lista e pjesëmarrjes në trajnime, forume, seminare brenda dhe jashtë vendit gjatë vitit 2022)

PROKURIMI

Bazuar në Planin e Prokurimit për vitin 2022 nga 16 aktivitete të planifikuara të prokurimit janë realizuar 12 aktivitete ndërsa 4 aktivitete nuk janë iniciuar ose janë anuluar për arsye të ankesave, ndërsa në kuadër

të aktiviteteve të prokurimit janë iniciuar kërkesat për realizimin e aktiviteteve të prokurimit pranë AQP-së, nxjerrja e urdhër blerjeve në SIMFK dhe menaxhimi i kontratave.

MENAXHIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Përgjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2022, janë zhvilluar disa procese të rëndësishme të Teknologjisë Informative në kuadër të avancimit dhe digjitalizimit. Projekti i TI-së për digjitalizimin e të dhënave të Agjencisë, gjatë vitit raportues janë ndryshuar dhe ri-zhvilluar në modulet e deklarimit elektronik dhe të menaxhimit të rasteve në përputhje me ndryshimet ligjore të ligjit për Agjencinë dhe atij për Deklarimin e Pasurisë. Projekti përfshin deklarimin on-line të pasurisë (e-deklarimi i pasurisë), menaxhimin e rasteve të kontrollit të pasurisë, të konfliktit të interesit dhe është i mbështetur financiarisht nga UNDP-ja.

Në aspektin e menaxhimit dhe administrimit, gjatë vitit raportues vazhduar menaxhimi dhe administrimi i të gjitha pajisjeve të rrjetit kompjuterik të Agjencisë (Serverët, routerët, sitch-të, etj.), përfshirë edhe menaxhimin dhe azhurnimin e të dhënave elektronike të deklarimit të pasurisë. Përmes sistemit elektronik të deklarimit dhe regjistrimit të pasurisë – SDRP është bërë ruajtja elektronike e të dhënave, si dhe gjenerimi i regjistrave të deklarimit të pasurisë për të gjithë zyrtarët që kanë realizuar deklaramet e tyre gjatë vitit raportues, të cilët regjistra janë publikuar në ueb faqen e agjencisë: https://akk-ks.org/deklarimi_i_pasuris/171/deklarimet/171. Në kuadër të sistemit (SDRP) është realizuar edhe hedhja e shortit për të gjithë zyrtarët e lartë publik të cilët kanë bërë deklaramin e pasurisë në vitin 2022, ku përmes këtij procesi të hapur dhe transparent është përpiluar lista e deklaruesve nga vetë sistemi, dhe pastaj nga e njëjta listë është përzgjedhur një numër i rastit, i cili numër është zgjedhur nga një gazetar prezent në ceremoninë e hedhjes së shortit. Sistemi SDRP ka përzgjedhur çdo të pestin zyrtar nga lista duke filluar nga numri i përzgjedhur i rastit dhe ka krijuar një listë të re, e njohur si lista e kontrollit të plotë të deklarimit të pasurisë me zyrtarët e lartë publik, të cilët iu kanë nënshtruar procesit të kontrollit të plotë të deklarimit të pasurisë. Gjatë vitit raportues janë realizuar, ose janë proceduar për realizim edhe aktivitete të tjera të teknologjisë informative si: blerja e disa kompjuterëve për stafin dhe blerja e disa UPS-ve.

TË DHËNA STATISTIKORE LIDHUR ME GJENDJEN E PARANDALIMIT TË KORRUPSIONIT QË KA TË BËJË ME KOMPETENCAT E AGJENCISË

Nga numri total i rasteve të pranuar në Agjenci, të paraqitura në mënyrë kronologjike në raportin vjetor të punës, statistikave dhe analizat e rasteve të trajtuara nga Agjencia, tregojnë se krahasuar me vitet paraprake, rezultatet e punës janë të dukshme dhe kanë shënuar rritje të vazhdueshme të numrit të kërkesave dhe rasteve të adresuara për trajtim në Agjenci në fushat e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, të bazuara në kompetencat e Agjencisë për parandalimin konfliktit të interesit, saktësisë së raportimit të pasurisë, parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik dhe rastet e sinjalizimit.


PROCEDURA ADMINISTRATIVE E HETIMEVE PARAPRAKE

Në kuadër të procedurës administrative të hetimeve paraprake, gjatë vitit raportues, Agjencia trajtoi gjithsej 619 raste nga të cilat 267 raste janë përcjellë në Prokurori dhe Polici për procedim të mëtutjeshëm, 4 raste janë deleguar për trajtim në institucione të tjera (Inspektorat Policor, Shëndetësor apo edhe të Arsimit), 16 raste janë përcjellë në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore, 267 raste janë mbyllur, ndërsa 65 raste janë në procedurë.

Diferenca e raportimit mes dy vjetëve 2021 dhe 2022 përshkruhet me faktin se në vitin 2022 numri i informatave të trajtuara është rritur për 100% sa ishte në vitin 2021 me gjithsej 375 raste të trajtuara, 150 raste ishin përcjellë në Prokurori, Polici për procedim të mëtutjeshëm, 2 raste ishin përcjellë në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore, 71 raste ishin të mbyllura, ndërsa 152 raste ishin në procedurë të cilat janë trajtuar gjatë vitit 2022.

Karakteristikë e numrit të rasteve të trajtuara në kuadër të procedurës administrative të hetimeve paraprake, është rritja e numrit të inicimit të rasteve për trajtim në mënyrë ex-officio, me 66 raste të trajtuara në vitin 2020 dhe 76 raste të trajtuara në vitin 2021, inicimi i rasteve për trajtim në mënyrë ex-officio ndryshoi dukshëm në vitin 2022 dhe u trefishua në krahasim me vitet paraprake me gjithsej 415 raste të iniciuara nga Agjencia për trajtim në mënyrë ex-officio.

Paralel me rritjen e numrit të kërkesave të inicimit të rasteve në mënyrë ex-officio është rritur edhe dinamika e trajtimit të rasteve duke mos aplikuar mundësinë për shtyrjen e afatit të trajtimit të rasteve prej 6 muajsh, siç është mundësuar me legjislacionin në fuqi dhe bëri të mundur që numri i rasteve të bartura nga viti aktual në vitin pasues të zvogëlohet dukshëm, krahasuar me vitet paraprake. Në vitin 2023, janë bartur 65 raste të vitit 2022, përderisa në vitin 2022, janë bartur 152 raste të vitit 2021 ndërsa në vitin 2021 janë bartur 61 raste të vitit 2020.




TRAJTIMI I RASTEVE PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT

Angazhimi i Agjencisë në parandalimin e konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik përmes nxjerrjes së vendimeve, opinionëve, rekomandimeve, këshillimeve për institucionet, zyrtarët publik, me rastin e paraqitjes së situatave të mundshme të konfliktit të interesit në periudhën raportuese janar-dhjetor 2022, Agjencia trajtoi gjithsej 233 raste. Nga numri total i rasteve, 176 raste janë trajtuar me paraqitjen e kërkesave nga personat fizik apo juridik, 35 raste janë trajtuar sipas detyrës zyrtare, 14 raste janë trajtuar nga raportimet e mediave dhe Organizatave Jo-Qeveritare, dhe 8 raste janë trajtuar nga informatat e pranuar në formë anonime.

Krahas rritjes së numrit të rasteve për parandalimin e konfliktit të interesit, u rrit edhe efikasiteti dhe dinamika e veprimeve në trajtimin e rasteve që ndikoi të reduktohet dukshëm numri i rasteve të bartura për trajtim nga viti aktual në vitin pasues. Për dallim nga viti 2021 që u bartën për trajtim 25 raste të vitit 2020, dhe gjithashtu në vitin 2022 u bartën 21 raste të vitit 2021, pavarësisht se numri i trajtimit të rasteve u dyfishua përgjatë vitit 2022, shtimi i efikasitetit dhe dinamikës së veprimeve ndikoi që të barten vetëm 16 raste në vitin 2023.


Sikurse në ndryshimet e dinamikës së veprimeve të paraqitura më lartë edhe numri i rasteve të parandalimit të konfliktit të interesit të trajtuara nga autoritetet përgjegjëse të institucioneve shënoi rritje në vitin 2022, krahasuar me vitet paraprake. Në vitin 2020 nga autoritetet përgjegjëse janë trajtuar 46 raste, në vitin 2021 nga autoritet përgjegjëse janë trajtuarin 101 raste, ndërsa në vitin 2022 numri i rasteve të trajtuara nga autoritet përgjegjëse është gjithsej 121 raste të trajtuara.




DEKLARIMI DHE KONTROLLI I PASURISË

Karakteristikë e procesit të deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë është krahasimi i tre viteve në procesin e deklarimit të pasurisë që rezulton me rritjen e përgjegjësisë së zyrtarëve të lartë publik për deklarimin e pasurisë brenda afateve ligjore. Në vitin 2020 nga gjithsej 4721 subjekte deklaruese, 4625 ose 97.97% deklaruan pasurinë sipas afatit ndërsa 96 ose 2.03% të zyrtarëve nuk e respektuan afatin ligjor të deklarimit të pasurisë. Në vitin 2021 nga 4892 subjekte deklaruese, 4783 ose 97.77% deklaruan pasurinë sipas afatit, ndërsa 109 ose 2.03% të zyrtarëve nuk e respektuan afatin ligjor të deklarimit të pasurisë. Viti 2022, shënoi një rritje të llogaridhënies dhe përgjegjësisë së zyrtarëve të lartë publik për ta deklaruar pasurinë brenda afateve të përcaktuara me legjislacionin fuqi, nga gjithsej 4748 subjekte deklaruese. 4687

ose 98.72%) deklaruan pasurinë sipas afatit, ndërsa 61 ose 1.28% të zyrtarëve nuk e respektuan afatin ligjor të deklarimit të pasurisë. Nga numri i përgjithshëm i zyrtarëve të lartë publik që kanë për obligim deklarimin e pasurisë kontrolli i plotë i pasurisë është realizuar për gjithsej 973 zyrtar të lartë publik, sipas listës së shortit, ndërsa përveç listës së kontrollit të plotë të pasurisë, Agjencia ka iniciuar për trajtim ex-officio edhe 41 raste për zyrtar të lartë publik apo sipas informatave të raportuara nga qytetarët përmes formave të ndryshme.



Përkushtimi për të respektuar afatin kohor të trajtimit të rasteve të pranuar në Agjenci, duke mos shfrytëzuar mundësinë për shtyrjen e afatit të trajtimit të rasteve prej 6 muajsh, siç është parashikuar me legjislacionin e fuqi, bëri të mundur që numri i rasteve të bartura nga vitit 2022 në vitin 2023 të jetë dukshëm më i vogël për dallim nga vitet paraprake. Në vitin 2023, janë bartur 22 raste ose (1.34%) të vitit 2022, për dallim në vitin 2022, janë bartur 225 raste ose (23.29%) nga viti 2021 ndërsa në vitin 2021 janë bartur 661 ose (68.28%), raste nga viti 2020.



PARANDALIMI I KORRUPSIONIT NË PROKURIMIN PUBLIK


Me qëllim të parandalimit të shkeljeve të mundshme korruptive në prokurimin publik, Agjencia ka bërë monitorimin e aktiviteteve të prokurimit publik nga kërkesat e pranuar nga institucionet publike, monitorimin e publikimit të aktiviteteve të prokurimit në ueb faqen zyrtare të KRPP-së nga autoritetet kontraktuese, aktivitetet me vlerë të vogël të mëdha dhe të mesme. Në periudhën raportuese janar-dhjetor 2022, Agjencia ka trajtuar 218 raste lidhur me aktivitetet e prokurimit publik, të cilat me vendim janë iniciuar nën dyshimin e arsyeshëm për shkelje ligjore me elemente korruptive në aktivitetet e prokurimit që kanë rezultuar me nxjerrjen e 211 opinioneve, prej të cilave 162 opinione janë respektuar nga ana e institucioneve, 49 opinione nuk janë respektuar, 33 raste janë dërguar për hetim paraprak ndërsa 7 raste janë mbyllur.

Numri i rasteve të trajtuara në fushën e parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik – 2022

Numri i rasteve	i Opinione	Raste të mbyllura me raport	Opinione (te respektuara)	(te parespektuara)	Opinione (te NE HETIM)
218	211	7	162	49	33

Numri i rasteve të trajtuara për parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik, gjithashtu ka tejkaluar dukshëm numrin e trajtimit të rasteve në tri vjetët e fundit, nga 80 raste sa ishin trajtuar në vitin 2020 dhe 108 raste në vitin 2021, në periudhën raportues janar-dhjetor 2022 numri i trajtimit të rasteve u rrit në 100% me trajtimin e gjithsej 218 rasteve. Paralelisht me rritjen e numrit të rasteve të trajtuara gjatë vitit 2022, pas trajtimit të rasteve për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në prokurimin publik u nxorën 211 opinione që gjithashtu tejkaluan shumëfishin e opinioneve të vitit 2021, vetëm 18 opinione, ndërsa në vitin 2020, 54 opinione.


Rastet e trajtuara në fushën e parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik




LLOGARIDHËNIA DHE KOMUNIKIMI ME MEDIA

Qasja pro aktive dhe bashkëpunimit me media që aplikoi Agjencia në vitin 2022 dhe hapja e Agjencisë për të promovuar mandatin e saj ligjor në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, ndryshoi trendin e komunikimit me mediat dhe Organizatat Jo –Qeveritare duke rritur numrin e aktiviteteve të komunikimit publik në krahasim me vitet e mëparshme, në dyfishimin e kërkesave të mediave dhe OJQ-ve për të siguruar informata nga Agjencia. Nga gjithsej 177 kërkesa të adresuara nga subjekte të ndryshme, në periudhën raportuese janar-dhjetor 2022, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në kuadër të komunikimit publik, nga numri total i përgjigjeve, Agjencia ofroi 156 përgjigje për mediat, 17 përgjigje për Organizatat Jo Qeveritare dhe 3 përgjigje për studentë.

Kërkesat për informata 2022



Në kuptimin e diferencës mes viteve, në vitin 2022, Agjencia shënoi rritje të aktiviteteve të komunikimit me media nëpërmjet përgjigjeve të ofruara, krahasuar në tre vitet e fundit. Në periudhën raportuese janar-dhjetor 2022, Agjencia dyfishoi numrin e përgjigjeve për media nga 75 përgjigje më 2020, dhe 54 përgjigje në vitin 2021, në vitin 2022, numri i përgjigjeve për media u rrit në 165.




Karakteristikë e periudhës raportuese janar-dhjetor 2022, si rezultat i bashkëpunimit me media dhe Organizatat Jo-qeveritare, Agjencia trajtoi gjithsej 48 raste, të raportuara nga mediat dhe Organizatat Jo-Qeveritare në fushat me kompetencë të Agjencisë.

Gjatë periudhës raportuese janar- dhjetor 2022, Agjencia trajtoi 48 raste të raportuara nga mediat dhe Organizatat Jo-Qeveritare në fushat me kompetencë të Agjencisë, 12 raportime u pranuan nga Organizatat Jo-qeveritare ndërsa raportime 36 raportime nga mediat.

TRAJTIMI I RASTEVE TË SINJALIZIMIT

Trendi i rritjes së trajtimit të rasteve trajtimit të informative dhe raportimeve në Agjenci gjithashtu shënoi rritje edhe në paraqitjen e rasteve të sinjalizimit. Gjatë vitit 2022 janë trajtuar gjithsej 17 raste, prej të cilave nga viti 2021 janë bartur 3 raste, ndërsa në vitin 2022, janë pranuar 13 raste. Numri i rasteve të pranuar prej 13 raste gjatë vitit 2022, krahasuara me 9 raste sa janë raportuar gjatë vitit 2021, tregon një trend të rritjes së numrit të raportimeve.



ZBATIMI I KORNIZËS LEGJISLATIVE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE PËRMIRËSIMIN E KORNIZËS LIGJORE EKZISTUESE KUNDËR KORRUPSIONIT

Në zbatim të detyrimeve ligjore, lidhur me zbatimin e kornizës ligjore në fuqi si dhe përmirësimit të saj në raport me ndryshimet e reja legislative, në periudhën raportuese janar-dhjetor 2022, Agjencia ka vazhduar obligimet e saj ligjore sipas fushë veprimtarisë së saj të bazuara në kornizën ligjore primare dhe sekondare, varësisht nevojave dhe përgjegjësive të reja ligjore, mbi bazën e të cilave Agjencia ka funksionuar dhe vepruar sipas:

Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit si dhe në vazhdim Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Ligjit Nr. 04-L-050 Për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar;

Ligjit Nr. 04/L-228 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04-L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të personat zyrtar;

Ligjit Nr. 06/L-011 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik; dhe

Ligjit Nr. 06/L-085 Për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe aktet nënligjore:

Rregullorja Nr. 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit;

Kodi Nr. 03/2013 i etikës për nëpunësit e Agjencisë Kundër Korrupsionit; 5 - Rregullorja Nr. 01/2014 e punës e Agjencisë Kundër Korrupsionit;

Rregullorja Nr. 02/2014 për organizimin, funksionalizimin dhe menaxhimin e arkivit të Agjencisë Kundër Korrupsionit;

Rregullorja Nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 e punës e Agjencisë Kundër Korrupsionit; dhe

Rregullorja Nr. 01/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencia ka vepruar konform ndryshimeve dhe obligimeve të reja ligjore, duke filluar me zbatimin e planit të veprimit në përmbushje të obligimeve ligjore që kanë të bëjnë me plotësimin e kuadrit ligjor. Në këtë drejtim, janë identifikuar aktet nënligjore si dhe dokumentet tjera të cilat burojnë nga ndryshimet e reja legjislative.

Krahas kësaj, janë iniciuar veprime konkrete, në përgatitjen e analizave dhe veprimeve për zbatimin e obligimeve ligjore, janë j draftuar vendimet për Grupet Punuese, për hartimin e drafteve fillestare të akteve nënligjore, sipas fushëveprimit të ri të Agjencisë, është hartuar drafti i parë i Rregullores për Organizimin dhe Strukturimin e Brendshëm të Agjencisë, Metodologjia për Planet e Integritetit si dhe drafti i Metodologjisë për Vlerësimin e Legjislacionit kundër korrupsion, të cilat janë në fazën e rishikimit nga grupet punuese.

Për më tepër, Agjencia gjatë periudhës raportuese janar- dhjetor 2022 është angazhuar edhe rreth planifikimit të ndërmarrjes së veprimeve përkatëse sipas Ligjit të ri të Deklarimit të Pasurisë dhe Dhuratave i miratuar me 22.08.2022, dhe i cili hyn në fuqi në muajin Shkurt 2023. Janë identifikuar aktet normative si dhe dokumente tjera, për plotësimin e kornizës ligjore të cilat janë kërkesa ligjore sipas Ligjit të ri të Deklarimit të Pasurisë. Bazuar në nevojat dhe kërkesat ligjore të Agjencisë janë përpiluar parashtesa të shumta juridike (vendime, kërkesa, kontrata, memorandume mirëkuptimi) si dhe janë ofruar opinione apo këshilla profesionale për të gjitha njësitë organizative brenda institucionit, në analizimin e çështjeve të ndryshme brenda mandatit të institucionit dhe aktivitete të tjera që hyjnë në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisë të Agjencisë.


HETIMET ADMINISTRATIVE, INFORMATA PËR NUMRIN E RASTEVE TË REFERUARA NË AUTORITETET E ZBATIMIT TË LIGJIT DHE GJYQËSORE, PËRFSHIRË INFORMATA STATISTIKORE PËR SHKARKIMET NGA PUNA, HETIMET, AKTAKUZAT DHE VENDIMET NË LIDHJE ME RASTET E REFERUARA NGA AGJENCIA, KRAHASIME ME VITET E KALUARA DHE ANALIZA

Raportimet dhe informatat në lidhje me dyshimet për veprime korruptive u pranuar nga Agjencia përmes raportimit të drejtpërdrejtë nga qytetarët, linjës telefonike pa pagesë **0800 10 800**, raportimet përmes postës, raportimet përmes platformës - RAPORTO KORRUPSION dhe raportimet nëpërmjet adresës zyrtare të APK-së info@akk-ks.org. Për personat të cilët në mirëbesim kanë zbuluar informacionin për ekzistencën e korrupsionit dhe me qëllim të pengimit të pasojave të dëmshme ndaj tyre, Agjencia mundësoi që rastet e dyshuara të korrupsionit të paraqiten në mënyrë anonime me qëllim të ruajtjes së identitetit të raportuesve dhe inkurajimin e qytetarëve për raportimin.

Gjatë periudhës raportuese janar- dhjetor 2022, në proceduat e hetimeve paraprake, Agjencia trajtoi gjithsej 619 informata në total, ndërsa 267 raste janë përcjellë në Prokurori dhe Polici për procedim të mëtutjeshëm dhe 4 raste në institucione të tjera (Inspektorat Policor, Shëndetësor dhe të Arsimit), 16 raste të tjera janë përcjellë në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore, 267 raste janë mbyllur, ndërsa 65 raste janë në procedurë. Në krahasimin mes tri viteve, trendi i trajtimit të rasteve në vitin 2022 është rritur dukshëm. Në vitin 2021 nga 375 raste të trajtuara 150 raste ishin përcjellë në Prokurori, Polici për procedim të mëtutjeshëm, 2 raste ishin përcjellë në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore, 71 raste ishin mbyllur, ndërsa 152 raste ishin në procedurë të cilat janë trajtuar gjatë vitit 2022.

Numri i përgjithshëm i informacioneve anonime të trajtuara gjatë vitit 2022 ishte 36 ndërsa 415 raste u iniciuan sipas detyrës zyrtare (*ex-officio*).

Grafiku i mëposhtëm (*Figura 1*) pasqyron procedimin e 619 rasteve të trajtuara gjatë vitit 2022.



Paraqitja grafike e procedimit të rasteve të trajtuara gjatë vitit 2022

RASTET E REFERUARA NË AUTORITETET E ZBATIMIT TË LIGJIT DHE GJYQËSORE

Gjatë periudhës raportuese në institucionet kompetente për procedim të mëtutjeshëm janë përcjellë 267 kallëzime penale dhe informata, në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit janë përcjellë 190 kallëzime penale dhe 64 informata, për të cilat Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka njoftuar se ato janë deleguar në kompetencë të prokurorive respektive dhe 13 informata janë përcjellë Departamentin e Hetimeve dhe Krimeve Ekonomike të Kosovës (DHKEK) ndërsa 4 raste në kompetencë janë deleguar te organet kompetente respektive (2 raste në Inspektoratin e Arsimit, 1 në Inspektoratin Policor dhe 1 rast në Inspektoratin Shëndetësor). Në 16 raste, pas përfundimit të procedurave hetimore paraprake, është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të arsyeshëm se rasti mund të përbëjë vepër penale, por është dyshuar për shkelje administrative. Agjencia këto raste i ka përcjellë tek organet kompetente administrative me kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore.

Në mesin e 267 rasteve të përcjella në Prokurori dhe DHKEK- Policia e Kosovës për procedim të mëtutjeshëm, në disa prej tyre janë të përfshira dy e më shumë vepra penale. Veprat penale i përkasin kryesisht kapitullit XXXIV, Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, sipas Kodit Penal të Kosovës. Ndërsa në 40 raste (28 në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe 12 DHKEK), për veprimet e dyshuara nuk është arritur që të kualifikohen se çfarë figure të veprës penale paraqesin, për shkak të tejkalimit të mundësisë dhe kompetencës hetimore të Agjencisë.

Struktura e veprave penale të përcjella në institucionet kompetente dhe niveli i zyrtarëve të dyshuar, është si në vijim:

- ⇒ Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare - Numrin më të madh të rasteve të përcjella në Prokurori e përbëjnë veprimet e sanksionuara sipas nenit sipas Kodit nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës.
- ⇒ Keqpërdorimi i Pozitës apo autoritetit zyrtar - Nga numri i përgjithshëm i rasteve të përcjella në Prokuroritë dhe DHKEK- Policia e Kosovës, numrin e dytë më të madh të tyre e përbëjnë veprimet

korruptive të parapara sipas nenit 414 të Kodit nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 422 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovës.

- ⇒ Mashtrimi - të ngarkuar me këtë vepër penale e cila është e përcaktuar në nenin 323 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovës përkatësisht nenit 335 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovës, janë përcjellë 2 raste.
- ⇒ Konflikti i interesit - Sipas kësaj vepre penale të përcaktuar në nenin 417 të Kodit nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës përkatësisht nenit 422 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovës. në Prokurorinë kompetente janë përcjellë 2 raste, e në 1 rast tjetër kjo vepër ka qenë e përfshirë me veprën penale Keqpërdorimi i Pozitës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 414 të Kodit nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës si dhe veprën penale Deklarimi i rremë nën betim nga neni 383 të Kodit nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës. Personat e përfshirë në këto raste i përkasin pozitave të ndryshme si: Deputet, ish deputet, udhëheqës dhe ish zëvendës udhëheqës i organit të pavarur kushtetues, ministër, zëvendës ministër, koordinator nacional, kryetar komune, kryeprokuror prokurorie, gjyqtar, këshilltar i nënkryetarit të kuvendit të Kosovës, shef dhe ish shef kabineti në ministria, këshilltarë dhe ish këshilltar politik dhe të jashtëm të kabinetit qeveritar, sekretar të përgjithshëm në nivel qendror, ambasadorë, këshilltarë/ministër në ambasada, sekretar të dytë dhe të tretë, këshilltar të asambleve komunale, ish kryesues i këshillit drejtues në universitete publike, anëtarë dhe ish anëtar të këshillave drejtues në universitete publike, rektor, prorektorë dhe ish prorektor, dekanë, prodekanë në fakultete të universiteteve publike, sekretarë të fakultetit në universitete publike, drejtor dhe ish drejtor të përgjithshëm të institucioneve të pavarura, kryeshefa ekzekutiv të agjencive ekzekutive në kuadër të ministrive, anëtarë të këshillave drejtues të institucioneve vartëse në kuadër të ministrive, nënkryetarë dhe anëtarë të këshillave në Institucione të pavarura, drejtor departamentesh në institucione të pavarura, ministri apo agjenci ekzekutive, drejtor dhe ish drejtor drejtorie në komuna, menaxherë të prokurimit në nivel lokal, kryesor financiar në institucione në nivel qendror, udhëheqës personeli në nivel qendror, udhëheqës divizioni për buxhet dhe financa në nivel qendror, zyrtar prokurimi dhe zyrtar koordinues në nivel qendror, zyrtar i gjeodezisë dhe kadastral në nivel lokal, zyrtarë drejtorë klinikash, kryetar, anëtarë, bordesh të ndërmarrjeve publike qendrore dhe lokale, kryeshef ekzekutiv të ndërmarrjeve publike në nivel lokal dhe ud. Kryeshef ekzekutiv i ndërmarrjeve publike në nivel lokal, sekretar i përgjithshëm në ndërmarrje publike lokale, kryesues komisioni të auditimit në ndërmarrje publike qendrore, ndihmës auditor, udhëheqës ekipi i auditorëve dhe auditor në zyrën kombëtare të auditimit, auditor i brendshëm në nivel qendror, laborant në laborator të qendrave të mjekësisë familjare, etj.

INFORMATA STATISTIKORE PËR SHKARKIMET NGA PUNA, HETIMET, AKTAKUZAT DHE VENDIMET NË LIDHJE ME RASTET E REFERUARA NGA AGJENCIA

Pas zhvillimit të procedurës së hetimeve paraprake, Agjencia gjatë periudhës raportuese janar- dhjetor 2022 ka nxjerrë kërkesë me rekomandim dhe njoftime të cilat i ka adresuar tek institucionet relevante në Republikën e Kosovës, si në vijim:

- Informatë nëse të gjeturat e Agjencisë mund të kontribuojnë në eliminimin e shmangies së tatimit më një rast të caktuar.
- Kërkesë për vlerësim nëse angazhimet e të punësuarve të tyre në institucione të tjera pa kompensime mund të ndikojë në performancë të tyre.
- Njoftime për udhëheqësit e institucioneve që të marrin masa në mënyrë që të mos përsëriten situatat kur zyrtarët kontaktues me Agjencinë nuk i përcjellin njoftimet të zyrtarët e lartë publik rreth procesit të deklarimit të pasurisë.

AKTAKUZAT DHE VENDIMET NË LIDHJE ME RASTET E REFERUARA NGA AGJENCIA

Nga informacionet e pranuar gjatë vitit 2022, nga Gjykatat respektive lidhur me rastet e dyshuara për korrupsion sipas aktakuzave të ngritura nga Prokuroritë kompetente mbi bazën e kallëzimeve penale të Agjencisë, janë nxjerr 37 Aktgjykime dënuese dhe 1 aktgjykim lirues. Në mënyrë tabelore këto të dhëna sipas gjykatave duken si në tabelën vijuese.

Vendimet e gjykatave përkitazi me Nenin 437 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovë përkatësisht 430 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovë

Nr.	Gjykata	Aktgjykim dënues	Aktgjykim lirues
1	GJTH. Prishtinë	10	-
2	GJTH. Prizren	1	-
3	GJTH. Gjilan	4	-
4	GJTH. Gjakovë	9	-
5	GJTH. Mitrovicë	6	-
7	GJTH Pejë	3	1
8	GJTH Ferizaj	4	-
GJITHSEJ		37	1

Nga informacionet e pranuar gjatë vitit 2022, nga Gjykatat respektive lidhur me rastet e dyshuara për korrupsion sipas aktakuzave të ngritura nga Prokuroritë kompetente mbi bazën e kallëzimeve penale të Agjencisë, janë nxjerr 37 Aktgjykime dënuese dhe 1 aktgjykim lirues.

Me aktgjykime dënuese Gjykatat kanë shqiptuar kryesisht dënime me gjobë, ka raste kur janë shqiptuar edhe dënim me kusht (dënime me gjobë dhe burgim) po ashtu edhe dënim me burgim efektiv.

Dënimet me gjobë janë shqiptuar në shumë prej 100-euro deri në 800 euro. Tek këto dënime është caktuar që të paguhen kryesisht pas plotfuqishmërisë së aktgjykimeve dhe në disa raste me këste, me mundësinë e revokimit në dënim me burg, ku 20 euro do të llogaritet me një ditë burgimi në rast se i akuzuari nuk e paguan atë dhe e njëjta nuk mund të ekzekutohet me detyrim.

Dënimet me kusht kryesisht janë shqiptuar me dënime me burgim nga 3 muaj deri në 11 muaj me kohë të verifikimit deri në 2 vjet.

Ka raste kur Gjykata ka shqiptuar dënim me burgim efektiv, në kohëzgjatje prej 120 ditëve e të cilat me marrëveshje në mes Gjykatave dhe të dënuarve janë zëvendësuar me dënime me gjobë.

Aktgjykimet dënuese i referohen veprës penale nga neni 437 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovë, përkatësisht 430 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës, ku 23 raste për mos deklarim të pasurisë sipas paragrafit 1 të këtij neni, përkatësisht 20 raste janë për mos deklarim të rregullt vjetor të pasurisë e 3 rast për mos deklarim me rastin e mbarimit/shkarkimit nga funksioni dhe 14 raste për deklarim të rremë të pasurisë apo mos paraqitje të të dhënave të kërkuara në deklaratë sipas paragrafit 2 të këtij neni, përkatësisht 3 për mos paraqitje të saktë të të hyrave vjetore, 6 për mos paraqitje të biznesit (zotërimit të aksioneve në shoqëri tregtare), 1 për mos paraqitje të saktë të pasurisë së luajtshme (veturë) dhe 2 për mos paraqitje të saktë të pasurisë së paluajtshme, ndërsa 1 rast për mos paraqitje të biznesit (zotërimit të aksioneve në shoqëri tregtare) dhe pasurisë së paluajtshme dhe 1 rast për mos paraqitje të biznesit (zotërimit të aksioneve në shoqëri tregtare) dhe pasurisë së luajtshme (veturë).


Me aktgjykim lirues, 1 rast Gjykata ka liruar nga akuza të akuzuarin për mos paraqitje të biznesit (zotërimit të aksioneve në shoqëri tregtare).

Sa i përket 16 rasteve të përcjella me kërkesa për fillim të procedurave disiplinore nga ana e Agjencisë, nga institucionet kompetente administrative në 4 prej tyre Agjencia nuk ka marr ndonjë informatë, ndërsa

në 4 raste është shqiptuar masa disiplinore Vërejtje me gojë, në 2 raste është iniciuar procedura disiplinore, në 2 raste është vlerësuar se nuk ka pasur shkelje ligjore ndërsa në 1 rast tjetër vlerësohet se nuk ka bazë për inicim të procedurës disiplinore, në 1 rast shqiptohet masa disiplinore Ndalesë prej 20% të pagës mujore për një periudhë kohore prej tre muajve dhe në 2 raste të tjera shqiptohet masa tjetër disiplinore Ndalim i Avancimit për dy (2) vjet përkatësisht Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 4 vjeçare.

Në 267 rastet e përcjella në Prokurori dhe Polici të Kosovës për procedim të mëtutjeshëm penal pas konstatimeve se ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të arsyeshëm për përfshirjen në veprime korruptive, ka denoncuar 263 persona ndërsa 16 raste janë përcjellë në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj 4 personave zyrtarë të institucioneve të Republikës së Kosovës 4 raste të tjera janë përcjellë në organe të tjera (Inspektorat Policor, Shëndetësor edhe të Arsimit).

Figura 2, pasqyron në mënyrë grafike numrin e kallëzimeve penale, informatat dhe kërkesat për fillim të procedurës disiplinore dhe numrin e personave të përfshirë në rastet që e referuara te institucionet përkatëse.



Pasqyrimi i numrit të rasteve dhe numrit të personave të përcjellë te institucionet përkatëse

Karakteristikë e rasteve të hetuara që kanë të bëjnë me veprën penale *Keqpërdorim i Pozitës apo autoritetit zyrtar*, nga neni 422 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovës, përkatësisht neni 414 të Kodit nr. 06/L-074, është shfrytëzimi i detyrës apo autoritetit zyrtar nga personi zyrtar i cili me veprim apo mosveprim shkel ligjet e aplikueshme me qëllim përfitimi të çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër, apo me qëllim të shkakimit të dëmit për personat tjerë apo biznesin e caktuar, ose që seriozisht shkel të drejtat e personit tjetër, tejkalon kompetencat dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare.

Veprimet apo mos veprimet e përmendura i referohen shkeljeve si:

- Shfrytëzimi i pasurisë publike për përfitime personale jashtë orarit të rregullt të punës;
- Punësim pa ndonjë procedurë të rekrutimit;
- Përzgjedhja e të punësuarave në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
- Ndryshim i rregullave për të ardhura personale duke i ngritur vetvetes pagat;

- Punësime me kontrata për shërbime të veçanta duke mos zbatuar një procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit;
- Punësim pa i plotësuar kushtet e kërkuara me konkurs;

Vepra penale Keqpërdorim i Pozitës apo Autoritetit Zyrtar është karakterizuar kryesisht me shkelje të rregullave të rekrutimit (punësimit). Disa veprime të tjera të cilat e karakterizojnë këtë vepër penale për shkak të natyrës së tyre nuk janë prezantuar për faktin se publikimi i tyre do të mund të dëmtonte procesin e mëtutjeshëm të hetimeve.

Konflikti i Interesit - nga neni 417 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovë përkatësisht nenit 422 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovës, kjo vepër penale është karakterizuar me marrjen pjesë të personave zyrtar personalisht në çështje zyrtare të caktuar duke i mundësuar përfitim financiar përmes punësimi anëtarëve të familjes me rastin e nënshkrimit të kontratave.

Mashtrimi - nga neni 323 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovës përkatësisht nenit 335 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovës, është karakterizuar me fshehjen e fakteve të rëndësishme të cilat do të ndikonin me rastin e përzgjedhjes së tyre pozita të caktuara.

Mos deklarimi ose deklarimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare - nga 430 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovë. Karakteristikë e rasteve të hetuara të cilat kanë të bëjnë me këtë vepër penale është mos deklarimi i pasurisë brenda afateve të përcaktuara kohore sipas ligjit në fuqi (sipas deklarimit të rregullt vjetor, deklarimit me marrjen e detyrës, deklarimi pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni) dhe mosparaqitja e të dhënave të kërkuara si paluajtshmëria, pasuria e luajtshme në vlerë mbi tremijë (3000) Euro, zotërimi i aksioneve në shoqëri tregtare apo të hyrave vjetore.

Në periudhën raportuese, rastet për të cilat gjatë hetimeve Agjencia ka gjetur prova për vërtetimin e dyshimeve për veprime korruptive e të cilat janë përcjellë për procedim penal të mëtutjeshëm në institucionet kompetente, i takojnë viteve të ndryshme të kryerjes së tyre, duke filluar nga viti 2017-2022. Agjencia ka vazhduar të bashkëpunojë ngushtë me institucionet e zbatimit të ligjit. Prokuroria e Shtetit, në bazë të mandatit të saj ka vazhduar të kërkojë prova shtesë për të shkuar përtej dyshimit të arsyeshëm dhe të bazuar në lidhje me konstituimin e elementeve të veprës penale.

Dispozitat ligjore në fuqi parashohin rastet e pushimit të hetimeve dhe hedhjes poshtë të rasteve të iniciuara në fazën e hetimeve. Rastet janë hedhur poshtë nga Prokuroria në bazë të disa arsyeve, kryesisht mungesë të provave:

1. Ekzistojnë rrethana të tjera të cilat përjashtojnë ndjekjen – është vepër e rëndësishë së vogël;
2. Merren si referenca aktgjykimet liruese të Gjykatave Themelore;
3. Nuk është provuar dyshimi i bazuar se është kryer vepra penale;
4. Nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepra penale;
5. Në veprimet e të pandehurit nuk ekzistojnë elementet qenësore të veprës penale;
6. Mungon qëllimi si element qenësor i veprës penale;
7. Vërtetohet se nga pakujdesia nuk është arritur që të bëhet deklarimi i pasurisë brenda afateve të përcaktuara kohore;
8. Pasuria e padeklaruar është fituar në mënyrë ligjore, është lëshim teknik mos deklarimi i saj;
9. Mos deklarimi i pasurisë nuk është bërë me dashje me qëllim që ta fsheh ose mos ta deklaroj pasurinë;
10. Ka kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes penale;

Gjatë kësaj periudhe raportuese Agjencia pas zhvillimit të procedurave hetimore paraprahe ka mbyllur 267 raste. Arsyet për mbylljen e tyre janë si vijon, 232 raste janë mbyllur për shkak se pas zhvillimit të procedurës së hetimeve paraprahe është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim

të bazuar se rasti mund të përbëjë vepër penale apo shkelje administrative, 6 raste janë mbyllur në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, për shkak se Agjencia nuk ka pas kompetencën për zhvillimin e procedurës së hetimeve paraprake; dhe 29 raste janë mbyllur sepse për të njëjtat në të njëjtën kohë janë zhvilluar procedurë penale nga organet kompetente, ku prej tyre: 10 raste nga DHKEK-Policia e Kosovës, 6 nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, 3 nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, 2 nga Prokuroria Themelore në Gjiilan, 2 raste nga Prokuroria Themelore në Pejë, 2 nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë, 1 nga Prokuroria Speciale e Kosovës, 2 raste nga Njësia e veçantë e Hetimit në Policinë e Kosovës dhe 1 rast nga Stacioni Policor në Malishevë.

PËRFAQËSIMI I RASTEVE NË GJYKATA

Gjatë vitit 2022, Agjencia ka përfaqësuar gjithsej në 24 raste të iniciuara në institucionet e drejtësisë. Nga njëzetë e një (21) çështje penale, në pesëmbëdhjetë (15) prej tyre ka përfaqësuar në Gjykata dhe në gjashtë (6) raste në Prokurori. Çështjet penale për të cilat Agjencia ka përfaqësuar në Gjykata dhe Prokurori kryesisht kanë qenë për vepër penale: “Mos deklarimi ose deklarimit i rrejshëm i pasurisë, i të ardhurave, dhuratave ose i dobisë tjetër materiale” sipas Kodit Penal të Kosovës, përveç në një rast i cili ka qenë për vepër penale “Lidhje e Kontratës së Dëmshme”.

Ndërsa në tre (3) raste tjera Agjencia ka përfaqësuar si palë e paditur pranë Gjykatës kompetente për Çështje Administrative, të cilat kanë pasur për bazë konfliktin e interesit.

DEKLARIMI, ORIGJINA DHE KONTROLLI I PASURISË SË ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIK, PËRFSHIRË INFORMATA STATISTIKORE, KRAHASIME ME VITET E MËPARSHME DHE ANALIZA

Bazuar në obligimet ligjore të përcaktuara me Ligjin nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë, si dhe Ligjin nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtar, Agjencia ka vazhduar ta mbikëqyrë pasurinë e zyrtarëve të lartë publik të Deklarimit të rregullt vjetor, Deklarimit me marrjen e detyrës; Deklarimit sipas kërkesës së Agjencisë; dhe Deklarimit pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni.

Deklarimi i rregullt vjetor - Zyrtarët e lartë publik kanë për obligim deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë gjatë tërë kohës së punës në shërbimin publik në afatet e përcaktuara me ligj dhe janë të obliguar ta deklarojnë gjendjen e pasurive të tyre në APK, nga 1 deri më 31 mars të çdo viti për vitin paraprak nga 1 janar deri më 31 dhjetor. Deklarimin e rregullt vjetor për vitin 2022 kanë qenë të obliguar ta bëjnë gjithsej 4748 zyrtar të lartë publik.

Nga numri i përgjithshëm e kanë deklaruar pasurinë 4687, pasurinë nuk e kanë deklaruar 61 zyrtar të lartë publik, ndërsa 50 kanë deklaruar pasurinë pas afatit; 11 nuk kanë deklaruar pasurinë).

Lista e Deklarimit të rregullt vjetor sipas Institucioneve

Institucionet	Zyrtarëve e obliguar ta deklarojnë pasurinë	Kanë deklaruar	Deklarimi pas afatit	Nuk kanë deklaruar
Presidenca	17	16	1	0
Kuvendi	147	147	0	0
Qeveria	1476	1458	11	7
Gjykatat	403	403	0	0
Prokurorit	190	190	0	0
Institucionet e Pavarura	497	495	2	0
Komunat e Kosovës	1586	1546	36	4
Ndërmarrjet Publike	432	432	0	0
TOTALI	4748	4687	50	11

Për periudhën raportuese janar- dhjetor 2022, gjendja e përgjithshme e procesit të deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë paraqitet në tabelën në vijim përfshirë krahasimet me vitin 2021 dhe vitin 2022.

Vitet	Të obliguar për deklarim	Kanë deklaruar në afat	Nuk kanë respektuar afatin
2020	4721	4625 (97.97%)	96 (2.03%)
2021	4892	4783 (97.77%)	109 (2.23%)
2022	4748	4687 (98.72%)	61 (1.28%)

Deklarimi me marrjen e detyrës së zyrtarëve të lartë publik - Zyrtarët e lartë publik të cilët fillojnë punën në shërbimin publik në mënyrë të plotë dhe reale deklarojnë pasurinë e tyre brenda afatit ligjor në periudhën prej 30 ditësh nga dita e marrjes së detyrës.

Gjatë vitit raportues Agjencia ka pranuar informacione nga zyrtarët kontaktues të institucioneve se kanë filluar ushtrimin e funksionit publik 270 subjekte deklaruese që janë obliguar të deklarojnë pasurinë me rastin e marrjes së detyrës, 41 prej tyre nuk e kanë deklaruar pasurinë brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe janë proceduar për trajtim të mëtutjeshëm të hetimit administrativ.

Për periudhën raportuese janar- dhjetor 2022, gjendja e përgjithshme e procesit të deklarimit të pasurisë deklarimit me marrjen e detyrës paraqitet në tabelën në vijim, përfshirë krahasimet me vitin 2021 dhe vitin 2022.

Vitet	Të obliguar për deklarim	Kanë deklaruar në afat	Nuk kanë respektuar afatin
2020	608	608 (100%)	0 (0%)
2021	980	938 (95.71%)	42(4.29%)
2022	270	229 (84.82%)	41 (15.18%)

Deklarimi i pasurisë pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni – Me rastin e përfundimit të angazhimit në pozitën e lartë publike, zyrtarët e lartë publik janë të obliguar ta bëjnë deklarin e pasurisë brenda afatit tredhjet (30) ditor.

Gjatë vitit raportues Agjencia ka pranuar informacione nga zyrtarët kontaktues se ushtrimin e funksionit publik e kanë përfunduar 107 zyrtarë, të obliguar të deklarojnë pasurinë pas largimit nga funksioni publik dhe nga numri i përgjithshëm 18 zyrtar të lartë publik nuk kanë deklaruar pasurin brenda afatit të përcaktuar dhe janë proceduar për trajtim të mëtutjeshëm të hetimit administrativ.

Për periudhën raportuese janar- dhjetor 2022, gjendja e përgjithshme e procesit të deklarimit pas mbarimit të funksionit publik paraqitet në tabelën në vijim për vitin 2020, 2021 dhe vitin 2022.

Vitet	Të obliguar për deklarim	Kanë deklaruar në afat	Nuk kanë respektuar afatin
2020	364	364 (100%)	0
2021	1072	1046 (97.57%)	26 (2.43%)
2022	107	89 (83.18%)	18 (16.82%)

Në kuadër të zbatimit të ligjit dhe ndërmarrjen e veprimeve për mos respektim të obligimeve ligjore për deklarimin e rregullt të pasurisë deklarimin me rastin e marrjes së detyrës dhe deklarimit me rastin e përfundimit të funksionit publik, në vitin 2022 Agjencia ka vazhduar për hetim të mëtutjeshëm në procedura administrative për 121 raste.

Bazuar në të dhënat e raportuara gjatë vitit 2022, për të gjitha llojet e deklarimit të pasurisë, kanë qenë të obliguar ta bëjnë deklarin 5125 zyrtar të lartë publik, sikurse në tabelën në vijim.

Lloji i deklarimit	Të obliguar
Deklarimi i rregullt vjetor	4748
Me marrjen e detyrës	270
Sipas kërkesës	-
Pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni	107
Numri i përgjithshëm	5125

KONTROLLI I DEKLARIMIT TË PASURISË

Bazuar në mandatin që ka, APK ka zhvilluar kontrollin paraprak dhe kontrollin e plotë të formularëve për deklarim të pasurisë të paraqitur nga zyrtarët e lartë publik.

Kontrolli paraprak - Kontrolli paraprak kryhet për çdo formular për të verifikuar saktësinë e raportimit të pasurisë nëse ne të nijetit mund të jenë evidentuar lëshime të mundshme dhe gjatë procesit të kontrollës paraprake të regjistrave të deklarimit të pasurisë janë evidentuar 634 raste dhe janë kërkuar përmirësime dhe plotësimin e të dhënave sipas kërkesave sipas kërkesave të formularit dhe legjislacionit në fuqi.

Kontrolli i plotë - Bazuar në obligimet ligjore, Agjencia ka zhvilluar procesin e kontrollit të plotë të pasurisë për ta verifikuar saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të deklaruara në formularët e deklarimit të pasurisë për zyrtarët e lartë publikë të cilët deklarojnë pasurinë, për 20% nga numri i përgjithshëm i deklarimeve në bazë të shortit të organizuar më 15 qershor 2022.

Procesi i kontrollit të plotë të pasurisë u realizua duke bërë krahasimin e të dhënave të deklaruara ndër vite, krahasimin e të dhënave të pranuar nga institucionet tjera si: Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Ministria e Financave, Ndërmarrjet Publike, Agjencia e Regjistrimit të Civil, Administrata Tatimore e Kosovës, Universitetet Private, Njësia e Inteligjencës Financiare, Dogana etj.

Nga numri i përgjithshëm i zyrtarëve të lartë publik që kanë për obligim deklarimin e pasurisë kontrolli i plotë i pasurisë është realizuar për gjithsej 973 zyrtar të lartë publik, sipas listës së shortit, ndërsa përveç listës së kontrollit të plotë të pasurisë, Agjencia ka iniciuar për trajtim ex-officio edhe 41 raste për zyrtar të lartë publik -officio apo sipas informatave të raportuara nga qytetarët përmes formave të ndryshme.

Tabela e mëposhtme pasqyron procesin e kontrollit të plotë.

Kontrolli i plotë i deklarimit të pasurisë si dhe rezultatet e gjetjeve nga kontrolli i plotë

Sipas listës së shortit	ex-officio	Gjithsej në kontroll	Të përfunduara	Në procedurë	Të përcjella për hetim në procedura Administrative (APK) / Prokurori/Polici	
					Mos deklarim te pasurisë	Dyshimet për deklarim të rrem
932	41	973	960	13	121	57

Procedura e realizimit të kontrollit të plotë të pasurisë për tri vitet e fundit:

Vitet	Kontrolli i plotë	Rastet e mbyllura	Rastet e proceduara për procedim në procedure administrative	Raste të bartura	Rastet (officio) e trajtuara sipas informatave anonime apo OJQ
2020	968	942 (97.31%)	26 (2.69%)	661 (68.28%)	18
2021	966	916 Përshkrimi me përqindje% (94.82%)	50 Përshkrimi me përqindje% (5.18%)	225Përshkrimi me përqindje% (23.29%)	12
2022	973	916 % (94.14%)	57 % (5.86%)	13 (1.34%)	41

PRANIMI I DHURATAVE NË LIDHJE ME KRYERJEN E DETYRËS ZYRTARE

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-050 si dhe Ligjin Nr. 04/L-228, Institucionet publike duhet t'i emërojnë zyrtarët përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të dhuratave. Të gjitha dhuratat e pranuar dhe vlera e tyre përkatëse, si dhe emrat e personave që kanë dhënë dhuratën, duhet të regjistrohen në regjistrin e dhuratave nga personi zyrtar që përcaktohet nga Agjencia dhe që mbahen nga institucioni, në të cilin personi zyrtar ushtron detyrën. Kopjet e katalogëve duhet t'i dërgojnë në APK jo më vonë se më 31 mars të vitit në vijim.

KONTROLI I DHURATAVE

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, gjatë muajit mars të vitit 2022 ka pranuar njoftimin nga 158 institucione, të cilat kanë deklaruar se kanë pranuar dhurata 16 nga këto institucione, ndërsa 142 kanë deklaruar se nuk kanë pranuar dhurata gjatë vitit paraprak.

Institucionet të cilat kanë dorëzuar kopjet e katalogut të dhuratave gjatë këtij viti për vitin paraprak janë: Zyra e Presidentes, Kuvendi i Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Drejtësisë, Universiteti i Prizrenit, Agjencia Shtetërore e Arkivit, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësi dhe Tregtisë, Fondi i Kursimeve Pensionale, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit, Komuna e Gjakovës, Posta e Kosovës.

PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT NË EKZEKUTIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE, PËRFSHIRË INFORMATA STATISTIKORE, KRAHASIME ME VITET E MËPARSHME DHE ANALIZA

Në mbështetje të dispozitave Ligjit Nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, Agjencia ka ndërmarrë veprimet e duhura hetimore administrative për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit nëpërmjet nxjerrjes së vendimeve, opinioneve këshillave dhe rekomandimeve. Në përpjeke për të parandaluar konfliktin e mundshëm të interesit në institucione publike, Agjencia në vazhdimësi ka ofruar asistencë profesionale për Autoritetet Përgjegjëse në institucione publike, për t'i përgatitur ato sa më mirë në trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të paraqitjes së situatave të mundshme të konfliktit të interesit brenda institucioneve të tyre.

Veprimet e Agjencisë janë ndërmarrë në mënyrë objektive, të paanshme dhe profesionale e në zbatim të legjislacionit relevant në fuqi, përmes inicimit të rasteve sipas detyrës zyrtare, informacioneve të pranuar nga personat fizik apo juridik, informatat e pranuar në formë anonime dhe informatave nga publiku, me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesit në institucionet publike dhe në shërbim të forcimit të integritetit dhe transparencës institucionale në Republikën e Kosovës, me qëllim të forcimit të integritetit për ushtrimin e funksionit publik në mënyrë objektive të paanshme dhe transparente përkritazi me legjislacionin në fuqi.

Gjatë periudhës raportuese janar - dhjetor 2022, për parandalimin e mundshëm të konfliktit të interesit janë trajtuar gjithsej 212 raste. Nga numri total i rasteve, 155 raste janë trajtuar me paraqitjen e kërkesave nga personat fizik apo juridik, 35 prej tyre janë trajtuar sipas detyrës zyrtare, 14 raste janë trajtuar nga

raportimet e mediave dhe Organizatave Jo-Qeveritare, dhe 8 raste janë trajtuar nga informatat e pranuar në formë anonime.

Krahasuar me vitet paraprake, përkatësisht me tri vjetët e fundit, në periudhën raportuese janar- dhjetor 2022, Agjencia dyfishoi numrin e trajtimit të rasteve për parandalimin e konfliktit të interesit që i paraprinë ndryshimet në ekzekutiv dhe legjislativ, veçanërisht me marrjen e mandateve/funksioneve të reja nga zyrtarët e rinj dhe numri i kërkesave për trajtimin e konfliktit të interesit u rrit dukshëm dhe nga 168 raste

Institucioni	Rastet e paraqitura për konflikt të interesit	Raste që janë shmangur nga Konflikti i Interesit	Raste pa Konflikt Interesi	Raste të dërguara në gjykatë	Rastet e përcjella për hetim	Raste në procedurë	Opinione-Përgjigje
Presidenca	2	1	-	-	-	-	1
Kuvendi i Kosovës	46	18	4	-	2	3	19
Qeveria/Agjenci të Universitetet Publike	75	17	9	-	1	4	44
Gjykata	12	2	1	-	-	1	8
Prokuroria	20	2	1	-	-	2	15
Institucionet e Pavarura	16	5	2	-	1	2	6
Ndërmarrje Publike	36	2	10	-	-	1	23
Pushteti Lokal	26	2	7	1	-	3	13
Gjithsej:	233	49	34	1	4	16	129

sa ishin trajtuar në vitin 2020 dhe 105 raste në vitin 2021, numri i rasteve të trajtuara në vitin 2022 u rrit për më shumë se 100% rezultoi me trajtimin e gjithsej 233 raste.

Paralel me numrin e rritjes së rasteve për parandalimin e konfliktit të interesit, u rrit edhe efikasiteti dhe dinamika e veprimeve në procedurat e trajtimit të rasteve brenda afateve ligjore ndikoi direkt në trajtimin e rasteve me kohë brenda vitit kalendarik 2022, duke reduktuar numrin e rasteve të bartura nga viti në vit. Për dallim nga viti 2021, që u bartën për trajtim 25 raste të vitit 2020 dhe gjithashtu në vitin 2022 u bartën 21 nga viti 2021, pavarësisht se numri i trajtimit të rasteve u dyfishua përgjatë vitit 2022, efikasiteti i veprimeve ndikoi që të barten vetëm 16 raste në vitin 2023.

Nga numri total i rasteve të trajtuara nga Agjencia përgjatë vitit 2022, për 129 raste të trajtuara u ofruan këshilla dhe opinione, 49 subjekte të trajtuara ju shmangën konflikt të interesit, 34 rezultuan pa konflikt të interesit, 1 rast u dërgua në Gjykatën kompetente për trajtim, dhe 4 raste të tjera në procedurën e hetimit paraprak. Nga numri i përgjithshëm i rasteve të trajtuara: 49 raste rezultuan me shmangie të konfliktit të interesit me funksione të dyfishta/papajtueshmëri në ushtrim të funksionit publik, ndërsa 1 rast me shmangie të konfliktit të interesit në proces të rekrutimit.

Nga numri i përgjithshëm i rasteve të trajtuara, 35 raste të trajtuara, u iniciuan për trajtim në mënyrë *ex-officio*, 9 raste u trajtuan nga raportimet e adresuara nga mediat, dhe 5 të tjera u adresuan nga Organizata Jo-Qeveritare.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ka përcaktuar si autoritet përgjegjëse për trajtimin dhe parandalimin e konfliktit të interesit Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, megjithatë neni 20 i ligjit ka përcaktuar se konflikti i interesit duhet të trajtohet edhe nga ana e autoriteteve përgjegjëse të institucioneve që përfshinë udhëheqësit e drejtpërdrejtë të zyrtarëve, sipas hierarkisë, brenda një institucioni si dhe ka obliguar institucionet që në kuadër të akteve të tyre të brendshme të parashohin dhe zbatojnë rregulla të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit, varësisht fushëveprimit të institucioneve publike.

Sikurse në ndryshimet e dinamikës së veprimeve të paraqitura më lartë, viti 2022 u karakterizua më rritje të numrit të trajtimit të rasteve nga autoritetet përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit. Për dallim nga vitet 2020 ku nga autoritetet përgjegjëse u trajtuan 46 raste, në vitin 2021 u trajtuan 101 raste, në vitin 2022 nga autoritetet përgjegjëse u trajtuan 121 raste.

Gjithashtu, në funksion të parandalimit të konfliktit të interesi, gjatë vitit 2022, Agjencia ka ofruar edhe 63 përgjigje (këshilla, rekomandime dhe sqarime), përmes komunikimit elektronik (email-it zyrtar), për institucionet dhe zyrtarët publik sipas kërkesës së tyre.

Tabela me specifikat e rasteve të trajtuara nga Autoritetet Përgjegjëse gjatë vitit 2022;

Institucioni	Gjithsej raste të paraqitura për konflikt të interesit në AP	Raste që janë shmangur nga Konflikti i Interesit	Raste pa Konflikt Interesi	Raste me Konflikt Interesi/Dërguar në Procedurë Disiplinore	Opinion / Rekomandim	Raste ende në procedurë	Rastet e Dërguara në APK
Qeveria, Ministritë, Agjencitë Ekzekutive dhe Institucionet vartëse	105	53	18	3	1	7	23
Kuvendi i Kosovës	2	1	0	0	0	0	1
Gjykata /Prokuroria	3	0	2	0	0	0	1
Institucionet e pavarura	12	11	0	0	0	0	1
Ndërmarrje Publike	20	5	5	2	1	2	5
Pushteti Lokal	23	16	1	2	0	0	4
Gjithsej:	165	86	26	7	2	9	35

PARANDALIMI I KORRUPSIONIT NË PROKURIM PUBLIK DHE MONITORIMI

Me qëllim të parandalimit të shkeljeve të mundshme korruptive në prokurimin publik, Agjencia ka bërë monitorimin e aktiviteteve të prokurimit publik nga kërkesat e pranuar nga institucionet publike, monitorimin e publikimit të aktiviteteve të prokurimit në ueb faqen zyrtare të KRPP-së nga autoritetet kontraktuese, aktivitetet me vlerë të vogël të mëdha dhe të mesme. Në periudhën raportuese janardhjetor 2022, Agjencia ka trajtuar 218 raste lidhur me aktivitetet e prokurimit publik, të cilat me vendim janë iniciuar nën dyshimin e arsyeshëm për shkelje ligjore me elemente korruptive në aktivitetet e prokurimit që kanë rezultuar me nxjerr 211 opinioneve, prej të cilave 162 opinione janë respektuar nga ana e institucioneve, 49 opinione nuk janë respektuar, 33 raste janë dërguar për hetim paraprak ndërsa 7 raste janë mbyllur.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, në gjashtëmuorin e dytë të vitit, aktivitetet e monitorimit për parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik, janë përshtatur me rregullativën e përcaktuar me ligjin e ri të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Numri i rasteve të trajtuara në fushën e parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik – 2022

Numri i rasteve	Opinione	Raste të mbyllura me raport	Opinione (te respektuara)	Opinione (te parespektuara)	NE HETIM
218	211	7	162	49	33

Numri i rasteve të trajtuara në fushën e parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik – 2021

Numri i rasteve	Opinione	Raste të mbyllura me raport	Opinione (te respektuara)	Opinione (te parespektuara)	Këshilla me telefon (te respektuar)	Këshilla me telefon (te pa respektuara)
108	18	7	18	0	64	19

Numri i rasteve të trajtuara në fushën e parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik – 2020

Numri i rasteve	Opinione	Raste të mbyllura me raport	Opinione (te respektuara)	Opinione (te parespektuara)	Ne procedure	Ne hetim
80	54	21	51	3	4	1

VLERËSIMI I RREZIKUT DHE I AKTEVE LIGJORE KUNDËR KORRUPSION

Konform obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin për Agjencinë në Parandalimin e Korrupsionit, sa i përket kompetencave të reja shtesë, Vlerësimi të rrezikut nga korrupsioni dhe Vlerësimi të akteve ligjore kundër korrupsionit, Agjencia ka ndërmarrë veprimet përgatitore për zbatimin e përgjegjësive ligjore në lidhje me vlerësimin e rrezikut si dhe vlerësimin kundër- korrupsion të akteve ligjore.

Në kuadër të përgjegjësiave, Agjencia ka filluar të bëjë një analizë krahasuese të legjislacionit aktual dhe akteve nënligjore mbi nevojën për të prezantuar një vlerësim të rrezikut të korrupsionit, dhe krijimin e parakushteve për eliminimin e rreziqeve të mëtejshme. Në kuadër të zbatimit të këtij veprimi, Agjencia ka planifikuar që në strukturën e re organizative të Agjencisë që pritet të funksionalizohet në vitin 2023, të sigurojë që kjo përgjegjësi ligjore të zbatohet nga një njësi e specializuar e Agjencisë. Përgatitja e metodologjisë së Vlerësimit të Korrupsionit, përveç legjislacionit vendor, do të marr në konsideratë edhe rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën, autoriteteve legjislative dhe ekzekutive, në nivel shtetëror dhe vendor, detyrimet ligjore me qëllim ngritjen e nivelit të ndërgjegjësimit lidhur me përmbushjen e obligimeve të përcaktuara për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Metodologjia për vlerësim të potencialit të korrupsionit në legjislacion do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Drejtori i Agjencisë dhe do të jetë e orientuar në eliminimin e rrezikut të korrupsionit dhe shkallën e përputhshmërisë së legjislacionit vendas me standardet ndërkombëtare, dhe analizën e akteve nën-ligjore të institucioneve publike për eliminimin e fushave të rrezikut dhe zbrazëtirave ligjore të cilat mund të përdoren për keqpërdorim të mundshëm të detyrës zyrtare.

PLANET E INTEGRITETIT

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencia ka ndërmarrë veprime konform obligimeve të saj në raport me Planet e Integritetit, të cilat tashmë me legjislacionin e ri obligojnë të gjitha institucionet publike të hartojnë planet e tyre të integriteti.

Planet e integritetit kanë për qëllim përkritjen e Metodologjisë që është e orientuar në analizën e veprimeve që paraqesin rrezik të shfaqjes së korrupsionit në institucionet publike gjatë ushtrimit të funksionit publik dhe veprimeve përgjatë proceseve vendimmarrëse. Në kuadër të përgatitjes së Metodologjisë, është përgatitur lista e rreziqeve që ka për qëllim identifikimin dhe analizimin e akteve nën-ligjore të institucioneve publike dhe masat për parandalimin e mundshëm të veprimeve korruptive. Ndër të tjera, Planet e integritetit do të bazohen në Vetë-vlerësimin e ekspozimit të institucionit ndaj korrupsionit dhe formave të tjera të përcaktimit të llojit të rreziqeve të korrupsionit dhe format e tjera të cenimit të integritetit dhe masat parandaluese për zvogëlimin e rrezikut të korrupsionit.

Në kuadër të kësaj, Agjencia ka themeluar Grupin Punues dhe në muajin mars 2023 do të përfundojë hartimin e Metodologjisë për Planet e integritetit, e cila do të shërbejë si udhëzues për të gjitha institucionet se si të hartojnë planet e tyre të integritetit. Metodologjia unike me udhëzimet për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Drejtori i Agjencisë, e cila do të publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

BASHKËPUNIMIN ME INSTITUCIONET VENDORE

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet vendore, në përmbushje të obligimeve ligjore, gjatë periudhës raportuese, Agjencia ka bashkëpunuar me të gjitha institucionet relevante në kuadër të zbatimit të fushë veprimtarisë së saj janë zhvilluar një varg takime, pjesëmarrje në plotësimin dhe hartimin e legjislacionit primar dhe sekondar dhe veprime të tjera, përkritazi me kërkesat dhe nevojat e Agjencisë. Aktivitetet dhe përfaqësimet në iniciativat e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve me institucionet vendore të nivelit të lartë janë zhvilluar nga Drejtori i Agjencisë si në vijim:

- Në kuadër të takimeve për harmonizimin e legjislacionit të Agjencisë dhe obligimet institucionale për përgatitjen e akteve nënligjore, Drejtori i Agjencisë, gjatë viti 2022, ka zhvilluar tri takime me Ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu;
- Drejtori i Agjencisë ka takuar Auditoren e Përgjithshme të Zyrës Kombëtare të Auditimit, znj. Vlora Spanca./28 janar 2022;

- Drejtori i Agjencisë ka takuar Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Albert Zogaj për të diskutuar për avancimin e bashkëpunimit mes Agjencisë dhe KGJK-së për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë. /18 mars 2022;
- Drejtori i Agjencisë ka zhvilluar një takim me Kryetarin e Kryeqytetit, Përparim Rama. / 29 korrik 2022;
- Drejtori i Agjencisë ka zhvilluar takim me përfaqësues të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit. /03 gusht 2022;
- Drejtori i Agjencisë ka zhvilluar takim me Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar. /23 gusht 2022;
- Drejtori i Agjencisë ka zhvilluar takim me Kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti për të diskutuar për koordinimin e aktiviteteve për zbatimin e obligimeve ligjore dhe përgatitjen e Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit. /06 shtator 2022;
- Drejtori i Agjencisë ka zhvilluar një takim me Guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës. /08 shtator 2022;
- Drejtori i Agjencisë ka zhvilluar një vizitë njoftuese në Këshillin Prokurorial të Kosovës. /14 shtator 2022;
- Drejtori i Agjencisë ka takuar Ushtruesin e Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi. /29 shtator 2022;
- Drejtori i Agjencisë ka takuar kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Malokun. /29 shtator 2022;
- Drejtori i Agjencisë ka takuar Drejtorin e Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj. /04 tetor 2022;
- Drejtori i Agjencisë ka zhvilluar një takim me Kryeshefin e Inspektoratit Policor të Kosovës, Kushtrim Hodaj më 04 tetor 2022;
- Në kuadër të angazhimeve për të dhënë kontributin profesional të përfshirjes në hartimin e legjislacionit primar në Kosovë, Drejtori i Agjencisë, në cilësinë e anëtarit ka marrë pjesë në Grupin Punues për Byronë për Konfiskimin e Pasurisë, si dhe në Këshillin për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut, i themeluar nga Presidentja e Republikës së Kosovës. /23.9.2022
- Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në Dëgjimin Publik për Projektligjin nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore./23 shtator 2022
- Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në takimin i Këshillit për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut./02 dhjetor 2022
- Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në takimin për Projekt Ligjin e Pagave dhe Projekt Ligjin e Zyrtarëve Publik. /6 tetor 2022
- Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në takimin e Komitetit Drejtues i Strategjisë për Sundimin e Ligjit/ 27.07.2022
- Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në takimin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik në bashkëpunim me USAID përmes projektit 'Aktiviteti për Integritet të Komunave të Kosovës/ 22.12.2022. Në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional, varësisht nga iniciativat për nisma të hartimit të legjislacionit, përfaqësues të APK-së kanë kontribuar me pjesëmarrje dhe angazhim profesional në Grupe Punuese për hartimin e legjislacionit nga institucionet publike.
- Plotësim ndryshimi i Ligjit për Agjencinë për Parandalim të Korrupsionit /Ministria e Drejtësisë;
- Plotësim ndryshimi i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave/Ministria e Drejtësisë;
- Hartimi i Ligjit për Pronarët Përfitues / Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;

- Hartimi i Rregullores për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;
- Plotësim ndryshimi i Ligjit për Prokurimit Publik/ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;

BASHKËPUNIMIN ME ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE DHE INSTITUCIONE TË HUAJA

Bashkëpunimi ndërkombëtar është realizuar edhe nëpërmjet përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së Drejtorit dhe stafit të Agjencisë në aktivitete brenda dhe jashtë vendit përfshirë pjesëmarrje në vizitat ndërkombëtare dhe rajonale, përfaqësime në konferenca rajonale dhe aktivitete të tjera me qëllim të përfaqësimit të Agjencisë dhe shkëmbimit të përvojave me të mira në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit:

- Në kuadër të shkëmbimit të përvojave për luftimin e korrupsionit me institucionet homologe, ndërkombëtare, 6 dhe 7 korrik 2022, Drejtori i Agjencisë dhe zyrtarë të Agjencisë ka zhvilluar vizitë zyrtare në Francë (PARIS), të organizuar nga Ambasada e Francës në Kosovë dhe zhvilluar takime me përfaqësues të lartë institucioneve në Paris, Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm të Autoritetit të Lartë për transparencën në jetën publike Michel Smaniotto, përfaqësues të Këshillit të Lartë Gjyqësor në Francë, Zyrës Qendrore për Luftën kundër Korrupsionit dhe Kundërvajtjet Financiare dhe Tatimore si dhe Prokurorinë e Shtetit për çështje Financiare në Gjykatën e Parisit/6 dhe 7 korrik 2022.
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, ka përfaqësuar Kosovën në Konferencën Rajonale me temën “Kultura e Integritetit: Masat përforcuese kundër korrupsionit” organizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Administratës Publike të Kroacisë në bashkëpunim me Inicativën Globale kundër Krimit të Organizuar, në Shibenik të Kroacisë. /23 maj 2022.
- Drejtori i Agjencisë ka marr pjesë në Komitetin Drejtues të PECK III dhe takime tjera bilaterale, në Strasburg, Francë 17-18 maj 2022, të organizuar nga Projekti i përbashkët i Këshillit të Evropës/Bashkimi Evropian kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK III). / 17 dhe 18 mars 2022.
- Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në Punëtorinë Rajonale për Promovimin e Integritetit në Sektorin e Sigurisë: “Sinjalizuesit”, të organizuar nga RACVIAC në Zagreb, Kroaci më 18-19 maj 2022.
- Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në seminarin dy ditor të organizuar nga Këshilli i Evropës/BE kundër Krimit Ekonomik (PECK III) Hartimit dhe zbatimit të programit efektiv të pajtueshmërisë kundër korrupsionit (AC) në sektorin privat. /12 tetor 2022
- Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në Punëtorinë e organizuar nga OECD “Takimi i 12 i rrjetit të ACN për zbatimin e ligjit”, në Stamboll-Turqi. / 19-21 tetor 2022,
- Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në takimin e nivelit të lartë të vendimmarrësve kundër korrupsionit dhe takimin e grupit drejtues, të organizuar nga Rrjeti kundër Korrupsionit për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, në kuadër të OECD në Paris. /16 dhe 17 Nëntor 2022,
- Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në takimin rajonal “Traktati Ndërkombëtar për Shkëmbimin e të Dhënave për Verifikimin e Deklaratës së Pasurisë”, në Podgoricë, Mali i Zi. / 20 dhjetor 2022.

BASHKËPUNIMI RAJONAL

- Inicativës së parë për bashkëpunim rajonal me institucionet homologe, i ka paraprirë takimi i Drejtorit të Agjencisë, me inspektoren e përgjithshme të inspektoratit të lartë të deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe konfliktit të interesave në Shqipëri, znj. Evgjeni Bashari, në kuadër të shkëmbimit të përvojave për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik gjatë vitit 2022, janë realizuar dy takime. /10 shkurt dhe 13 qershor 2022

- Iniciativat për të forcuar bashkëpunimin rajonal dhe shkëmbimit të përvoja për parandalimin e korrupsionit, ka vazhduar me takimin e Drejtorit të Agjencisë me znj. Biljana Ivanovska, Kryetare e Komisionit dhe anëtarët Shtetëror të Komisionit për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) në Maqedoninë e Veriut. / 07 shtator 2022

Gjatë vitit 2022, Agjencia ka rritur dukshëm numrin e aktiviteteve për të forcuar bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtarë në Kosovë dhe Drejtori i Agjencisë dhe zyrtarët e tjerë kanë zhvilluar aktivitetet si në vijim:

- Drejtori i Agjencisë ka takuar Udhëheqësin e Zyrës së Këshillit të Evropës (KE), në Kosovë z. Frank Power. /26 janar 2022;
 - Drejtori i Agjencisë ka takuar përfaqësuesen e Përherhme të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, znj. Maria Suokko. / 26 janar 2022;
 - Drejtori i Agjencisë ka zhvilluar takim njoftues Ambasadorin Zviceran në Kosovë z. Thomas Kolly. / 27 janar 2022;
 - Drejtori i Agjencisë ka takuar Zëvendës shefin e Ambasadës Franceze në Prishtinë, z. Francois Cyprien. /16 shkurt 2022;
 - Drejtori i Agjencisë ka takuar shefin e Zyrës së BE-së/EUSR, ambasadorin Tomas Szunyog. /24 shkurt 2022;
 - Drejtori i Agjencisë ka takuar Ambasadoren e Republikës së Francës në Kosovë, Marie- Christine Butel. /12 maj 2022;
 - Në ditën botërore kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë ka pritur në takim shefin e Zyrës së BE-së/EUSR, ambasadorin Tomas Szunyog./9 dhjetor 2022;
 - Drejtori i Agjencisë ka zhvilluar takim me Drejtoreshën e INL, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, Tamra Greig./8 dhjetor 2022;
 - Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në ceremoninë e Prezantimit të Raportit të tretë publik të Monitorimit të Drejtësisë të EULEX-it. /24 nëntor 2022.
- Në kuadër të angazhimeve dhe aktiviteteve të Organizatave ndërkombëtare që mbështesin punën e Agjencisë në parandalimin dhe luftimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në aktivitetet:
- Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në aktivitetin e Projektit për luftimin e korrupsionit në krimin ekonomike (PECK III)./11 tetor 2022
 - Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në takimin e Bordit të Projektit ceremoninë SAEK III/UNDP./14 tetor 2022.
 - Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në takimin e katërt i Këshillit Drejtues të projektit PECK III./10 nëntor 2022.

AKTIVITETET E AGJENCISË NË ORGANIZIMET PËR SHKËMBIM TË PËRVOJA DHE BASHKËPUNIM RAJONAL

- Takimi i 3-të i Komitetit Drejtues të PECK III dhe takime tjera bilaterale, Strasburg, Francë 17-18 maj 2022, organizuar nga Projekti i përbashkët i Këshillit të Evropës/Bashkimi Evropian kundër Krimin Ekonomik në Kosovë (PECK III).
Takimi u organizua paralelisht me një sërë takimesh tematike që synojnë të paraqesin dhe diskutojnë mjetet metodologjike të zhvilluara nga Këshilli i Evropës në fushat tematike të mbuluara nga PECK III dhe morën pjesë përfaqësues të të gjitha institucioneve kryesore përfutuese dhe të

Zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë. Në takime u diskutua për zbatimin e projektit dhe arritjet e tij, si dhe për aktivitetet e vazhdueshme dhe të ardhshme.

- Punëtorja Rajonale për Promovimin e Integritetit në Sektorin e Sigurisë: “Sinjalizuesit”, organizuar nga RACVIAC/ 18-19 maj 2022, Zagreb-Kroaci,
Në Punëtori, Agjencia është përfaqësuar nga një zyrtar dhe pjesëmarrës të tjerë ishin përfaqësues nga shtetet e rajonit, përkatësisht nga Institucionet e Parandalimit të Korrupsionit, ndërsa, është diskutuar Promovimi i Integritetit në Institucione publike, e në veçanti edhe Sinjalizimi.
- Punëtorja “Masterclas - Nga heshtja në veprim”, Shkup-Maqedoni e Veriut, nga RAI. /30.09.2022
Në punëtori është trajtuar ndër të tjera çështja se si Institucioni publik mund të komunikojë në mënyrë efektive me publikun dhe median të drejtat e sinjalizuesit, përmes prezantimit të shembujve të komunikimit dhe diskutimit të udhëhequr nga ekspertët.
- Punëtorja “Takimi i 12 i rrjetit të ACN për zbatimin e ligjit”, në Stamboll-Turqi, nga OECD. /19-21 tetor 2022
Në këtë punëtori është diskutuar dhe trajtuar për teknikat moderne të hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve të korrupsionit.
- Takimi i nivelit të lartë të vendimmarrësve kundër korrupsionit dhe takimin e grupit drejtues, mbajtur në Paris, të organizuar nga Rrjeti kundër Korrupsionit për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, në kuadër të OECD. /16 dhe 17 Nëntor 2022
Takimi ofroi një mundësi unike për të diskutuar arritjet dhe sfidat në luftën kundër korrupsionit, identifikimin e drejtimeve strategjike për punën e ardhshme dhe konfirmoi angazhimin e vendeve për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin.
- Organizuar nga Ambasada e Francës dhe Ministrisë së Drejtësisë së Francës, është mbajtur Seminari rajonal për Parandalimin dhe Dënimin e Korrupsionit, më 9 nëntor në Shkup (Maqedonia e Veriut) me 4 shtete, Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut dhe e ftuar si mysafire ishte gjithashtu Qiproja (e cila sapo ka krijuar një agjenci kombëtare kundër korrupsionit). / 19 tetor 2022
Në Seminarin me temën “Pse ka nevojë për Agjenci Nacionale”, Agjencia u përfaqësua nga një zyrtar që prezantoi rolin mandatin dhe kompetencat e Agjencisë në raport me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, të arriturat dhe sfidat.
- Në kuadër të iniciativave rajonale, një përfaqësues nga Agjencia për Parandalimin Korrupsionit ka marrë pjesë në “Iniciativën rajonale Udhërrëfyese rajonal kundër korrupsionit dhe financave të paligjshme të organizuar nga UNDOC për vendet e Ballkanit perëndimor nga viti 2021” që përbëhet nga 6 vendet e Ballkanit perëndimorë: Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia. /Wien 6 -8 nëntor dhe Lubjanë dhe 28 nëntor - 02 dhjetor.
Në kuadër të këtij projekti përfaqësuesi i Agjencisë ka prezantuar nevojat e Agjencisë në fushën e bashkëpunimit rajonal për shkëmbimin e informatave për parandalimin e korrupsionit dhe ka marrë pjesë në tri aktivitete të realizuara në Dubrovnik 10-14 tetor.
- Organizuar nga Ambasada e Francës dhe Ministrisë së Drejtësisë së Francës, është mbajtur Seminari rajonal për Parandalimin dhe Dënimin e Korrupsionit, në Shkup (Maqedonia e Veriut) përfaqësuesi i Agjencisë ka marrë pjesë në Seminarin me temën “Pse ka nevojë për Agjenci Nacionale” që ka mbledhur përfaqësues nga Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut dhe Qiproja ku është diskutuar për metodat e bashkëpunimit gjyqësor dhe administrativ ndërmjet shteteve dhe shkëmbimin e përvojave mes shteteve pjesëmarrëse për forcimin e mekanizmave për luftimin e korrupsionit./ 09 nëntor 2022.
Në Seminar, përfaqësuesi nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka prezantuar rolin mandatin dhe kompetencat e Agjencisë në raport me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, të arriturat dhe sfidat. 09 nëntor 2022.

- Organizuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës është mbajtur Punëtorja rajonale “Lufta kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit”, u realizuar me datë 20-21 në Strasburg(Francë) nga Projekti Rajonal për Forcimin e Masave për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Ekonomik, të programit të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Partneriteti për Qeverisje të Mirë" (PGG) për të mbështetur vendet e Partneritetit Lindor që synon të forcojë kapacitetet e vendeve të rajonit për të luftuar dhe parandaluar korrupsionin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit si dhe bashkëpunimin me media dhe organizata Jo –qeveritare. / 20-22 dhjetor 2022

Në punëtori Agjencia u përfaqësua nga një zyrtar që prezantoi fushëveprimin e dhe mandatin e Agjencisë në raport me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit si dhe mori pjesë në forumin e diskutimit për bashkëpunimin e institucioneve me grupet e interesit dhe prezantoi aktivitetet e Agjencisë në raport të bashkëpunimit me OJQ-të dhe mediat. Në punëtori morën pjesë përfaqësues nga Shqipëria, Armenia, Azerbajxhani, Bosnja dhe Hercegovina, Gjeorgjia, Republika e Moldavisë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Turqia dhe Ukraina.

AKTIVITETET MEDIATIKE

Si rezultat i përbushjes së qëllimit për të realizuar mandatin e saj me transparencë dhe llogaridhënie, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) ka rritur maksimalisht numrin e veprimeve konkrete duke bashkëpunuar me të gjithë akterët relevant për parandalimin e korrupsionit në Kosovë dhe në periudhën raportuese janar-dhjetor 2022 ka realizuar një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve mediale, të vetëdijesimit të publikut të gjerë.

Aktivitetet mediale të Agjencisë gjatë vitit 2022 u fokusuan në komunikimin me media, organizmin e konferencave, intervistave për media dhe bashkëpunimin me mediat në inicimin e trajtimit të rasteve për parandalim të konfliktit të interesit, procedurat e hetimeve administrative dhe dyshime për deklaramin jo-të saktë të pasurisë si dhe nëpërmjet publikimit pro-aktiv të informatave në ueb-faqen e APK-së. Në vitin 2022, Agjencia organizoi tri konferenca për media:

- Konferenca për media (përfundimi i procesit të deklarimit të pasurisë) - Rezultatet nga procesi i deklarimit të pasurisë,
- Hedhja e shortit për kontrollin e plotë të pasurisë 20% të subjekteve deklaruese – Për të siguruar procesin transparent, numri përzgjedhës për hedhjen e shortit u bë nga përfaqësuesi i organizatës Jo-Qeveritare FOL dhe nga gazetarja e mediumit Ekonomia online.
- Lancimi i fushatës informuese për mandatin e ri të APK-së – Fushata informuese u lancua me paraqitjen e produkteve televizive në prezencën e përfaqësuesve të Zyrës së BE-së në Kosovë, mediave dhe Organizatave Jo-Qeveritare.

Në kuadër të informimit dhe llogaridhënies publike dhe përgjigjeve në kërkesat e gazetarëve gjatë vitit 2022, u realizuan gjithsej 26 paraqitje mediale të realizuara në mediat vizuale, prej tyre 9 intervista, ndërsa me qëllim të informimit të zyrtarëve publik lidhur me detyrimet ligjore për deklarimin e pasurisë vetëm gjatë muajit shkurt- qershor 2022, Drejtori i Agjencisë realizoi 5 intervista.

- ✓ Më datë 25 janar, pas publikimit të raportit të Transparency International për Kosovën, është dërguar në media komunikata “Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit (AKK), Yll Buleshkaj ka deklaruar se do t’i trajtoj me prioritet rekomandimet e këtij publikimi për Kosovën, në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit”.
- Më 13 tetor - Pas dorëzimit të Raportit të vendit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2022, është dërguar në media komunikata “Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), Yll Buleshkaj ka theksuar se “Rekomandimet e Raportit të vendit për Kosovën na inkurajojnë që në parandalimin dhe

luftimin e korrupsionit të punojmë së bashku me institucionet tjera me seriozitetin dhe përgjegjësinë më të lartë institucionale”.

Qasja pro aktive dhe bashkëpunimi me media që aplikoi Agjencia në vitin 2022 dhe krijimi i klimës së partneritetit me media dhe Organizata Jo –Qeveritare, ndryshoi trendin e komunikimit me media në krahasim me vitet e mëparshme dhe ndikoi dukshëm që numri i kërkesave të mediave për të siguruar informata nga Agjencia të dyfishohet në krahasim me vitet pasuese. Nga gjithsej 177 kërkesa të adresuara nga subjekte të ndryshme, në periudhën raportuese janar-dhjetor 2022, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në kuadër të komunikimit publik, nga numri total i përgjigjeve, Agjencia ofroi 156 përgjigje për mediat, 17 përgjigje për Organizatat Jo Qeveritare dhe 3 përgjigje për studentë.


Në kuptimin diferencës mes viteve, në vitin 2022, Agjencia dyfishoi numrin e aktiviteteve të komunikimit me media ndërmjet përgjigjeve të ofruara për mediat të krahasuar në tri vjetët e fundit. Nga 75 përgjigje të ofruara për mediat në vitin 2020, dhe 54 përgjigje në vitin 2021, në periudhën raportuese janar-dhjetor 2022, Agjencia ofroi përgjigje për gjithsej 165 pyetje të pranuar nga mediat.

Kërkesat nga mediat ishin të orientuara për sigurimin e informatave në lidhje me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, procesin e hetimeve paraprake, deklarimin e pasurisë, çështjet e parandalimit të konfliktit të interesit si dhe interesime për informata lidhur me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në prokurimin publik.

Bashkëpunimi me mediat u realizua edhe nga një dimension tjetër që në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikoi në ndërmarrjen e iniciativave të Agjencisë për parandalimin e korrupsionit, duke trajtuar me prioritet raportimet nga mediat në lidhje keqpërdorimin e mundshëm të detyrës zyrtare, konfliktin e mundshëm të interesit, deklarimin jo të saktë të pasurisë dhe veprave të tjera të kundërligjshme.


Karakteristikë e periudhës raportuese janar-dhjetor 2022, si rezultat i komunikimit dhe bashkëpunimit me media dhe Organizatat Jo-qeveritare, Agjencia trajtoi gjithsej 48 raste, të raportuara nga mediat dhe Organizatat Jo-Qeveritare në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesit, deklarimin e pasurisë dhe keqpërdorimin e mundshëm të detyrës zyrtare, nga të cilat 12 raportime u pranuan nga Organizatat Jo-qeveritare ndërsa 36 raportime nga mediat.

Agjencia trajtoi 48 raste të raportuara nga mediat dhe Organizatat Jo-Qeveritare në fushat me kompetencë të Agjencisë



Përkushtimi i Agjencisë për të forcuar komunikimin publik përkthazi me respektimin e legjislacionit për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë, rezultoi që më 12 dhjetor 2022, për herë të parë nga themelimi i saj, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) të marr mirënjohje nga Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ), në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE), çmimin “Për praktikën më të mirë në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve” dhe u shpërblye si institucioni me performancën më të mirë në zbatimin dhe promovimin e dy gjuhëve zyrtare në Kosovë.

Në kuadër të shtimit të mundësive për plasimin e informatave për Agjencinë më 14 shkurt 2022, Agjencia lancoi përdorimin e platformës së komunikimit nëpërmjet rrjetit social facebook, ndërsa publikimi i informatave dhe komunikimi publik vazhdoi të realizohet edhe nëpërmjet ofrimit të informatave të publikuara në ueb-faqen e Agjencisë dhe kuadër të transparencës së publikimit të informatave për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve publik, në ueb-faqen e APK-së <http://www.akk-ks.org> u publikuan mbi 5000 regjistra të deklarimit të pasurisë. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, Agjencia publikoi gjithsej 134 informata në platformat elektronike të komunikimit, 73 informata në ueb-faqen e Agjencisë dhe 81 informata në rrjetin social Facebook.



Imazhi publik i Agjencisë në media ishte pozitiv, pavarësisht nga fakti se në 4 raste, të pyetjeve të drejtuara nga mediat, për shkak të kufizimeve ligjore, Agjencia nuk ofroi informatën e kërkuar, raportet në media dhe organizata Jo-qeveritare ishin neutrale dhe të balancuara sa i takon bashkëpunimit dhe prezantimit të fushë veprimtarisë së Agjencisë.

AKTIVITETET E VETËDIJESIMIT TË PUBLIKUT

Me qëllim të informimit të zyrtarëve publik lidhur me respektimin e obligimeve të përcaktuara për deklarimin e pasurisë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka përgatitur spotin televiziv i cili është transmetuar në Radio Televizionin Publik të Kosovës (RTK) nga data 10 deri më 31 mars 2022.

Si rezultat i bashkëpunimit dhe vlerësimit të Organizatave Ndërkombëtare në Kosovë për punën e APK-së dhe edukimit publik, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, mbështetur nga Bashkimi Evropian në Kosovë, më 14 dhjetor 2022, Agjencia ka lancuar fushatën për informimin e publikut e cila nëpërmjet porosive të tri spoteve televizive, promovon rolin e saj në kontrollin e deklarimit të pasurisë nga zyrtarët, parandalimin e konfliktit të interesit si dhe hetimin e raporteve të sinjalizimit.

Fushata informuese “PËR KOSOVËN PA KORRUPSION”, që i bën thirrje publikut të raportoje korrupsionin, u lancua pas miratimit të ligjeve të reja të cilat e forcuan mandatin e Agjencisë duke i dhënë kompetenca dhe detyra shtesë, përfshirë sanksionimin e drejtpërdrejtë të zyrtarëve dhe vlerësimin e hapësirave për korrupsion në legjislacion. Spotet kanë filluar të transmetohen në Radio Televizionin Publik të Kosovës (RTK) më 07 dhjetor 2022.

Në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, Agjencia ndërmori veprime konkrete të bashkëpunimit me Organizatat Joqeveritare, që kanë fushëveprim parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe gjatë vitit 2022 Drejtori i Agjencisë realizoi tri takimeve me përfaqësuesit e Organizatave Jo-Qeveritare, me qëllim të realizimit të iniciativave të përbashkëta për parandalimin dhe luftimin e Korrupsionit.

Si rezultat i bashkëpunimit me Organizatat Jo-Qeveritare, mbështetur nga Ambasada Amerikane në Prishtinë më 23 dhjetor 2022, Drejtori i Agjencisë ka nënshkruar Marrëveshje të Bashkëpunimit mes Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit me Organizatën Jo-Qeveritare AKTIV që ka për qëllim vetëdijësimin e publikut në lidhje me raportimin e korrupsionit dhe ka për fokus raportimin e korrupsionit në formë elektronike përmes një aplikacioni mobil të veçantë i realizuar e në kuadër të projektit të Byrosë Ndërkombëtare për Lëndë Narkotike dhe Zbatim të Ligjit (INL) “Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunat me shumicë Serbe në Kosovë”.

Krijimi i mundësive të reja për punë praktike për të rinjtë, mundësoi që në kuadër të projektit SAEK III, mbështetur nga UNDP, katër studentë të angazhohen në Agjenci në periudhën janar – dhjetor 2022 për punë praktike dhe asistuan në angazhimin në njësitë organizative të Agjencisë në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve për realizimin e planit të punës.

Shtirja e aktiviteteve të komunikimit me qëllim të rritjes së besimit të qytetarëve në Agjenci, ka rezultuar gjithashtu me realizimin e katër takimeve me studentë si dhe pjesëmarrjes së Drejtorit të Agjencisë në katër aktivitete të organizuara nga Organizatat Jo-Qeveritare me qëllim të përfshirjes së të rinjve në iniciativat për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

- Drejtori i Agjencisë u takua me përfaqësues nga organizata Jo-Qeveritare “Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike” (ACDC) të Kryesuar nga Dusan Radakovic, zyrtar komunal dhe një grup studentësh të profileve të ndryshme ku prezantoi rolin e APK-së në raport me deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, hetimet administrative, parandalimin e konfliktit të interesit, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe bashkëpunimin rajonal. /15 mars 2022.
 - Drejtori i Agjencisë priti në takim studentët e Klinikës Ligjore të IKD-së dhe i informoi studentët lidhur me procesin e deklarimit të pasurisë së zyrtarëve publik dhe veprimet e Agjencisë -së deri në përfundimit e verifikimit të informatave dhe bërjen publike të regjistrave të deklarimit vjetor të pasurisë. 22 prill 2022
 - 20 maj Drejtori i Agjencisë , priti në takim, një grup studentësh të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina “para të cilëve prezantoi fushëveprimin e Agjencisë -së në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. /20 maj 2022.
- Në frymën e bashkëpunimit me Organizatat Jo-Qeveritare që realizojnë projekte për inkuadrimin e të rinjve në procese vendimmarrëse, Drejtori i APK-së morri pjesë në 3 aktivitete të tjera me përfshirjen e të rinjve dhe informimin për mandatin e APK-së.
- Me ftesë të Akademisë së Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Drejtori Agjencisë ka marrë pjesë në programin Akademia e të Rinjve për Integritet (YIA), i cili projekt synon të fuqizojë liderët e rinj. / 07 qershor 2022.

- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, facilitoi në sesionin “Etika në proceset e lidërshpit: Diskutime mbi dilemat etike”, në kuadër të Kampit Veror të Rinjve për Lidërshpit të organizuar nga Organizata Jo-Qeveritare Demokraci Plus dhe përkrahur nga Fondacioni Gjerman KAS. / 26 gusht 2022
- Drejtori i Agjencisë mori pjesë në “Konferencën vjetore të Parlamenti Rinor Evropian (PRE) me temën “Sinjalizimi dhe mbrojtja e sinjalizuesit në linjë me Direktivën e BE-së”, Drejtori i Agjencisë Yll Buleshkaj, inkurajoi të rinjtë të angazhohet projekte për mbrojtjen e sinjalizuesve. / 02 gusht 2022.

KËRKESAT PËR QASJE NË INFORMATA PUBLIKE

Gjatë periudhës raportuese, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit pranoi 12 kërkesa për qasje në dokumente publike, të cilat u trajtuan konform Ligjit. Nr. 06/L-081, Për Qasje në Dokumente Publike.

Nga gjithsej 12 kërkesa, për 7 nga kërkesat u ofrua qasje e plotë në informacion, ndërsa për 5 nga kërkesat, bazuar në dispozitat ligjore të legjislacionit në fuqi u ofrua qasje e pjesshme në informacion.



Profili e subjekteve që kërkuar qasje në dokumente publike: 5 kërkesa u pranuan nga mediat, 4 kërkesa u pranuan nga Organizata Jo-Qeveritare, 2 kërkesa nga persona privat, dhe 1 kërkesë u pranuar nga një zyrtar publik.



Qasje e plotë në informacion u ofrua në 7 kërkesa (4, Organizata Jo-Qeveritare; 2, Media, dhe 1 Person Privat) ndërsa natyra e kërkesave ishte si në vijim:

1. Kërkesë për listën e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim
1. Kërkesë për të dhëna për organizimin e APK-së
1. Kërkesë për të dhëna statistikore të trajtimit të rasteve nga APK
1. Kërkesë për të dhëna statistikore për trajtimin e rasteve nga AKP
2. Kërkesë për informatave trajtimit të rastit të parandalimit të konfliktit të interesit

Qasje e pjesshme në informacion u ofrua në 5 kërkesa (3 Media; 1, Zyrtar Publik dhe 1, Person privat)

- 4 Kërkesë për sigurimin e informatave ishin subjekt i hetimeve të cilat janë të mbrojtura me Ligjin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit
1. Kërkesë për sigurimin e informatave të cilat janë të mbrojtura me Ligjin për Mbrojtjen e të dhënave personale.

MËSIMET E NXJERRA DHE PRIORITETET NË TË ARDHMEN

Prioritetet e menaxhmentit të ri të Agjencisë për vitin 2023 të orientuara në transparencë dhe llogaridhënie duke garantuar paanshmëri dhe trajtim të barabartë të ushtrimit të fushë veprimtarisë së Agjencisë, ndikuan në rritjen e numrit të raportimeve në Agjenci sikurse në lajmërimet për dyshime të mundshme të korrupsionit, deklarimin e pasaktë të pasurisë gjithashtu edhe në raportimet për konflikt të mundshëm të interesit dhe veprimeve të mundshme korruptive në prokurimin publik duke paraqitur kërkesa të vazhdueshme për trajtim të rasteve nga grupe të ndryshme të interesit, institucionet, dhe zyrtarët më të lartë të shtetit për të kërkuar trajtim të rasteve nëpërmjet këshillave, përgjigjeve dhe opinionëve.

Marr për bazë numrin në rritje të kërkesave, sensibilizimi i zyrtarëve publik në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit do të jetë njëra ndër veprimet e Agjencisë në vitin 2023 dhe nëpërmjet realizimit të programeve të specializuara të trajnimeve për autoritetet përgjegjëse të konfliktit të interesit, Agjencia synon forcimin të ndërgjegjësimit dhe rritjen e integritetit të institucioneve publike në mënyrë që numri i rasteve të paraqitura për konflikt të mundshëm të interesit të zvogëlohet. Qëllimi i Agjencisë është që të

ngritë nivelin e standardit të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së zyrtarëve publik që vet zyrtarët të trajtojnë konfliktin e interesit gjatë procesit të vendimmarrjes dhe ushtrimit të funksionit zyrtar dhe më iniciativat vetanake t'i shmangin situatat e mundshme të konflikt të interesit.

Numri i kufizuar i resurseve profesionale dhe ekspertizës në Agjenci paraqitet të jetë sfidë në realizimin e mandatit të saj ligjor ndërsa prioritet për vitin 2023 mbetet profilizimi i Agjencisë konform përgjegjësie dhe kompetencave të reja të përcaktuara me Ligjin për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Ligjin për Deklarimin e Pasurisë duke shtuar numrin e stafit aktual dhe forcimin e ekspertizës profesionale me rekrutimin e stafit të ri. Rëndësinë dhe nevojën e plotësimit me kapacitete profesionale në Agjenci e ka thekuar edhe Raporti i Progresit për Kosovën Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën Shoqëruar me dokumentin Komunikimi nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komiteti i Rajoneve, i datës 12.10.2022 ka thekuar se “Kapacitetet e Agjencisë, për sa i përket numrit të stafit, burimeve të TI-së dhe trajnimeve, duhet të rriten. Një sistem i deklarimit elektronik po hyn në fuqi për të thjeshtuar procesin e deklarimit dhe dorëzimit si dhe për të rritur transparencën dhe saktësinë në monitorimin dhe verifikimin”.

Angazhimi i Agjencisë për instaluar sistemin e deklarimi On-line i pasurisë është prioritet i vitin 2023 dhe raportimi i pasurisë do të bëhet në platformën për deklarimin elektronik që do sjellë lehtësira dhe përparësi në publikimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik duke ngritur në një nivel më të lartë saktësinë e të dhënave dhe informatave të deklarimit të pasurisë, duke evituar lëshimet e mundshme që janë bërë në të kaluarën, ndërsa publikimi i regjistrave të deklarimit të pasurisë do të bëhet në një afat më të shpejt kohor duke rritur në shkallë dukshëm më të lartë transparencën në deklarimin e pasurisë së zyrtarëve publik.

Në vitin 2023, Agjencia do të vazhdojë të përmirësojë punën e saj në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies dhe fushatat informuese me qëllim të mëtejshëm të informimit të publikut të gjerë dhe atij profesional në lidhje me fushëveprimin e APK-së, do të intensifikohen. Forcimit të bashkëpunimit dhe komunikimit në forcimin e mekanizmave për parandalimin e korrupsionit dhe rritjen e besimit të qytetarëve për të raportuar dyshimet për korrupsion do të ju paraprijë zbatimi i planit vjetor për trajnime për punonjësit e Agjencisë në forcimin e kapaciteteve të komunikimit të brendshëm dhe bashkëpunimit me media dhe Organizata Jo-qeveritare. Në mungesë të ofrimit të shërbimeve nga kompania kontraktuese për të ju përgjigjur kërkesave të Agjencisë si dhe në mungesë së kapacitete profesionale të teknologjisë informative, brenda Agjencisë për publikimin e informatave dhe dokumenteve në ueb-faqen e Agjencisë, gjatë vitit 2022, janë evidentuar mangësi në publikimin e informatave, veçanërisht mungesa e publikimit të regjistrave të deklarimit të pasurisë.

Sinjalizimi dhe mbrojtja e sinjalizuesve gjithashtu përfaqëson një mekanizëm parandalues të korrupsionit që kontribuon në forcimin e përgjithshëm të integritetit të institucioneve të sektorit publik si dhe privat. Rritja e numrit të rasteve të sinjalizimit në Agjenci gjatë vitit 2022 dhe detyrimet për trajtim efektiv të raportimeve të sinjalizimit për parandaluar ekzistencën e mundshme korrupsionit, paraqet domosdoshmëri të shtimit të kapacitete profesionale të Agjencisë për të ngritur procesin e sinjalizimit në nivelin e dëshirueshëm në publik që do t'i kontribuonte krijimit të një klimë në të cilën sinjalizuesit do të ndihen të mbrojtur dhe të motivuar për të raportuar dyshimet e mundshme për afera korruptive.

Duke pasur parasysh rëndësinë për të shmangur hapësirat e mundshme të keqpërdorime të detyrës zyrtare, përkritazi me obligimet e përcaktuara me legjislacionin e ri dhe shtimin e kompetencave të Agjencisë për vlerësimin e rrezikut të korrupsionit në legjislacion dhe monitorimin e planeve të integritetit, në veprimet e saj për vitin 2023, Agjencia synon forcimin e ekspertizës profesionale dhe shtimin e kapaciteteve të saj për forcimin e mekanizmave për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë.

Rritja e bashkëpunimit me projektet dhe asistencës së partnerëve ndërkombëtarë që mbështesin punën e Agjencisë (UNDP – së (United Nations Development Program dhe projektit PEC III të Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë) synon realizimin e kërkesave dhe nevojat e identifikuara nga Agjencia për realizimin e planit vjetor të performancës së Agjencisë për vitin 2023.

RAPORT LIDHUR ME TRAJTIMIN E RASTEVE TË SINJALIZIMIT TË JASHTËM

Gjatë vitit 2022 janë trajtuar gjithsejtë 17 raste, prej të cilave nga viti 2021 janë bartur 3 raste, ndërsa në vitin 2022 janë pranuar dhe evidentuar 14 raste.

Numri i rasteve të pranuar prej 14 raste, gjatë vitit 2022, krahasuara me 9 raste sa janë raportuar gjatë vitit 2021, tregon 1 trend të rritjes së numrit të raportimeve.

Sa i përket rasteve të trajtuara gjatë vitit 2022, e të cilat janë trajtuar brenda afateve të parapara ligjore dhe epilogu i trajtimit të rasteve të sinjalizimit është si në vijim:

- 1 rast pas trajtimit në kuadër të sinjalizimit të jashtëm është përcjellë si Informatë në Prokurorinë e Shtetit.
- 1 rast është përcjellë si kërkesë për procedim të mëtutjeshëm te organi kompetent, sa i përket njërit pretendim të informatës; Ndërsa lidhur me dy pretendime tjera të informatës së pranuar, rasti është mbyllur, sepse është konstatuar se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për vërtetimin e shkeljeve ligjore sipas ligjit.
- 1 rast është përcjellë si kërkesë për fillimin e procedurës së kundërvajtës, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Kundërvajtje, sepse pas zhvillimit të procedurës së sinjalizimit të jashtëm, është konstatuar se ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për mos përmbushje të obligimeve sipas dispozitave të LMS, dhe kryerje të kundërvajtjes, nga ana e institucionit publik të caktuar.
- 1 rast është përcjellë si kërkesë për procedim të mëtutjeshëm te organi kompetent.
- 1 rast është refuzuar, sepse fillimisht raportuesi ka bërë sinjalizim publik, duke u tejkalluar sinjalizimin e brendshëm dhe atë të jashtëm.
- 1 rast është refuzuar, sepse Agjencia vlerëson se informacioni nuk përbën raportim për 1 kërcënim ose cenim të interesit publik, që është i mbrojtur në kuptim të dispozitës së nenit 5 të Ligjit nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, në ndërlidhje me dispozitën e nenit 3 paragrafi 1 pika 1.1 dhe 1.2. të këtij ligji.
- 1 rast është refuzuar, sepse konsiderojmë se rasti fillimisht duhet të trajtohet brenda institucionit përmes sinjalizimit të brendshëm.
- 1 rast është refuzuar, kemi vlerësuar se i njëjti fillimisht duhet të trajtohet brenda institucionit përmes sinjalizimit të brendshëm, i cili rast është paraqitur tek punëdhënësi i institucionit të caktuar publik, por është refuzuar nga i njëjti të trajtohet.
- Agjencia përmes 1 shkrese i është drejtuar punëdhënësit të institucionit publik të caktuar, përmes së cilës e ka njoftuar për obligimin për të kryer hetimin administrativ të sinjalizimit të brendshëm, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, në ndërlidhje me nenin 17 paragrafi 4 të këtij ligji.
- 2 raste janë refuzuar sepse, Agjencia nuk ka kompetencë për të vepruar.

Meqenëse rastet janë trajtuar në procedurë të hetimeve administrative, në kuadër të sinjalizimit të brendshëm, brenda institucionit publik të caktuar, punëdhënësit e këtyre institucioneve përmes shkresave janë njoftuar në lidhje me obligimin për të zbatuar paragrafin 9 dhe 10 të nenit 16 të Ligjit nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, që të vënë në dijeni organin kompetent për shkeljet ligjore të pretenduara që kanë rezultuar pas përfundimit të procedurës së brendshme të hetimit administrativ të sinjalizimit.

- 3 raste janë mbyllur, sepse rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar nuk përbën shkelje sipas ligjit
- 1 rast pas shqyrtimit dhe vlerësimit të informatës është mbyllur, sepse nuk ka pretendime konkrete, në bazë të cilave duhet të trajtohet rasti si sinjalizim i jashtëm.
- 1 rast është mbyllur sepse nuk i kemi konfirmuar të gjitha informatat/të dhënat të cilat parashihen të plotësohen nga ana e paraqitësit të rastit, sipas nenit 15, në ndërlidhje me nenin 3 paragrafi 1. pika 1.1 dhe 1.5 të Ligjit nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, në bazë të cilave duhet të trajtohet rasti si sinjalizim i jashtëm.
- 1 rast është mbyllur sepse informacioni për 1 kërcënim ose cenim të interesit publik nuk është raportuar nga personi në kontekstin e marrëdhënies së vet të punës.
- Informacioni është përcjellë në kompetencë të Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, në kuadër të Agjencisë, për tu trajtuar sipas Ligjit 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.
- 1 rast është mbyllur, sepse nuk janë konfirmuar të gjitha informatat/të dhënat të cilat parashihen të plotësohen nga ana e raportuesi të informatës, sipas nenit 15, në ndërlidhje me nenin 3 paragrafi 1. pika 1.1 dhe 1.5 të Ligjit nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, në bazë të cilave duhet të trajtohet rasti si sinjalizim i jashtëm.
- Informacioni është përcjellë edhe në adresë të Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit (DPK), nëse kjo informatë mund të trajtohet sipas Ligjit nr. 04/L-050, për Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë.

Agjencia, ka ofruar përgjigje/njoftime me shkrim në 7 raste, lidhur me informata të pranuar nga zyrtarë të institucioneve të ndryshme, të cilët kanë kërkuar informata rreth sinjalizimit, ose zyrtarë/persona anonim të cilët kanë provuar të raportojnë informacione për ndo1 kërcënim ose cenim të interesit publik, mirëpo gjatë vlerësimit dhe trajtimit fillestar të raportimit është konstatuar se nuk i përmbushin kushtet për t'u trajtuar sipas Ligjit Nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit të praktikave dhe përvojave, në funksion të zbatimit të Ligjit Nr. 06/L-085 Për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Agjencia në vazhdimësi ka zhvilluar takime dhe kontakte me zyrtarët përgjegjës për sinjalizimin në kuadër të institucioneve publike.

Raport gjashtë mujor lidhur me sinjalizimin, 01 janar - 30 qershor 2022

Agjencia, pas kërkesës nga Zyra e Presidentes së Kosovës, lidhur me zotimet e marra përsipër në Samitin për Demokraci sa i përket zbatimit të Ligjit nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, me datë 26.05.2022,

i është drejtuar me email zyrtarëve përgjegjës të Institucioneve Publike, prej të cilëve, ka kërkuar që të përgatisin Raport gjashtë mujor, (01 janar - 30 qershor 2022) lidhur me sinjalizimin dhe të 1jtin ta përcjellin në Agjenci. Të 1jtën kërkesë e kemi përcjellë si Rikujtim të zyrtarët përgjegjës për sinjalizim me datë 27.06.2022.

Prej 180 Institucioneve Publike, për të cilat Agjencia ka informacion që kanë të caktuar zyrtarin përgjegjës për sinjalizim, e të cilat janë njoftuar nga Agjencia lidhur me kërkesën nga Zyra e Presidentes së Kosovës, për raport gjashtë mujor lidhur me sinjalizimin, këtë raport e kanë përcjell në Agjenci 129 institucione publike, derisa 51 institucione publike nuk e kanë përcjellë këtë raport.

RAPORTET VJETORE NGA INSTITUCIONET PUBLIKE, SUBJEKTET PRIVATE, SI DHE RREGULLATORËT LIDHUR ME SINJALIZIMIN, 01 JANAR -31 DHJETOR 2022

Agjencia bazuar në nenin 29 paragrafi 2 të Ligjit nr.06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve, pranon nga institucionet publike, subjektet private, si dhe rregullatorët raportet vjetore lidhur me sinjalizimin për vitin paraprak deri më 31 dhjetor.

Lidhur me këtë, Agjencia zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim të institucioneve publike iu ka rikujtuar obligimin ligjor në kuptim të nenit 29 të Ligjit nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, si dhe nenit 17 të Rregullores Nr.03/2021, për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit, që si Institucion Publik të përgatisin Raportin Vjetor lidhur me sinjalizimin për vitin paraprak deri më 31 dhjetor dhe të 1jtin ta paraqesin në Agjenci më së voni deri me 31 janar të vitit vijues.

Andaj në kuptim të nenit 29 paragrafi 3 i Ligjit nr.06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve, Agjencia publikon Raport Vjetor të përgjithshëm lidhur me sinjalizimin për vitin 2022, sipas të cilit, këtë raport e kanë përcjell në Agjenci 141 institucione publike, respektivisht 157 zyrtarë përgjegjës (disa Institucione Publike që kanë shtrirje në territorin e Republikës së Kosovës, kanë caktuar zyrtarë përgjegjës edhe në njësitë e tyre regionale), dhe 2 subjekte private, ndërsa raportin nuk e kanë paraqitur 40 institucione publike.


PUBLIKIMI I EMRIT TË ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR PRANIMIN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË SINJALIZIMIT

Agjencia përmes një shkrese elektronike i është drejtuar zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim të Institucioneve Publike, prej të cilëve, ka kërkuar që në kuptim të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e sinjalizuesve në Kosovë, në koordinim me udhëheqësin e institucionit, të bëjnë publik identitetin e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim në faqen e internetit të institucionit të tyre, ndërsa institucionet që nuk kanë faqe zyrtare të internetit, deri në krijimin e një faqe të tillë, emrin e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim ta bëjnë publik në hapësirat e institucionit të tyre, respektivisht në tabelën e shpalljeve.

Është kërkuar gjithashtu që Agjencia të njoftohet lidhur me publikim e emrit të zyrtarit përgjegjës në faqen e internetit, dhe të njoftohet me kohë për çdo ndryshim të emrit të zyrtarit përgjegjës për sinjalizim.

Institucionet Publike, të cilat kanë informuar Agjencinë lidhur me publikimin e identitetit të zyrtarit përgjegjës për sinjalizim në faqen e internetit të institucionit dhe hapësirat e institucionit të tyre ose në forma tjera, respektivisht në tabelën e shpalljeve, janë gjithsejtë 130, respektivisht 134 zyrtarë përgjegjës (disa Institucione Publike që kanë shtrirje në territorin e Republikës së Kosovës, kanë caktuar zyrtarë përgjegjës edhe në njësitë e tyre regjionale).

SHTOJCA NR. 1. ORGANOGRAMI I AGJENCISË PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT (APK)



SHTOJCA NR.2. LISTA E PJESËMARRJES NË TRAJNIME, FORUME, SEMINARE GJATË VITIT 2022

Nr.	Lloji i Trajnimit	Organizon	Vendi	Data	Numri i Zyrtarëve Pjesëmarrësve
1.	Open-source Intelligence for asset	UNDP	Prishtinë	31.01.2022	1
2.	Luftimi i Korrupsionit dhe Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe financimit të Terrorizmit	BE/ Këshilli i Evropës	Francë	17-18.05.2022	2
3.	Promovimin e Integritetit ne Sektorin e Sigurisë, Sinjalizues	RAI	Kroaci	18-19.05.2022	1
4.	Kultura e Integritetit: Rritja e masave Kundër Korrupsion	MD-APRK	Kroaci	22-24.05.2022	2
5.	Deklarim i Pasurisë dhe Konflikti i Interesit	AKK	Shqipëri	09-10.06.2022	3
6.	Përmasimin e Legjislacionit,	Ballkan Tender Watch	Serbi	21-22.05.2022	1
7.	Kundër Korrupsioni dhe marrëdhënie me Media	Ambasada e Amerikës	Hungari	15.06-02.07.2022	1
8.	Lufta kundër korrupsionit në lidhje me çështjet publike	Ambasada Franceze	Francë	06-07.08.2022	5
9.	Kontrolli i menaxhimit financiar lidhur me sistemin e buxhetit	CEF-Qendra e ekselencës se Financave	Prishtinë	19-30.09.2022	1
10.	Zgjedhjet digjitale të politikave financiare, raportimi, shqyrtimi dhe publikimi	IFES-Fondacioni Ndërkombëtar e për Sistemet zgjedhore	Prishtinë	26-27.09.2022	2
11.	Seminar “ Masterclass”	RAI	Maqedoni e Veriut	29.09.2022	2
12.	Udhërrëfyesi rajonal kundër korrupsionit dhe financave të paligjshme për Ballkanin Perëndimore	UNODC-Zyra e Kombeve te bashkuara për Drogën dhe Krimin	Kroaci	11-13.10.2022	1
13.	Paratë nga rastet e trafikimit të drogës, bashkëpunimi më i mirë për rikuperimin e pasurive kriminale nga rastet e trafikimit të drogës	Ambasada e Francës në Beograd	Republika e Serbisë	12-13.10.2022	1
14.	Takimi i dymbëdhjetë për Zbatimin e Ligjit të rrjetit kundër Korrupsionit për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore	OECD-Organizata për bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim	Turqi	19-21.10.2022	2

15.	Parandalimi dhe dënimi i Korrupsionit "Perspektiva nga Franca dhe Evropa Juglindore	Ministria e Drejtësisë së Republikës së Francës	Maqedoni e Veriut	08.11.2022	1
16.	Takimi i nivelit të lartë të vendimmarrësve kundër Korrupsionit dhe takimet e grupit drejtues	OECD-Organizata për bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim	Francë	16-17.11.2022	2
	Zhvillim të Karrierës	Ambasada Britanike	Prishtinë	18.11.2022	2
17.	Fushata Digjitale e Komunitetit të Praktikës Transparente	IFES-Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet zgjedhore	Çeki	29-30.11.2022	1
18.	hetimin dhe ndjekjen penale të aseteve virtuale të lidhura me krimin, duke përfshirë kriptovalutat, dhe përdorimin e mjeteve analitike	OSBE	Prishtinë	05-08.12.2022	5
29.	Procesi i Klasifikimit të Vendeve të Punës për Zyrtarët Publik	MPB	Prishtinë	15.12.2022	1
20.	Kundër-korrupsioni, Shpëlarja e Parasë dhe Luftimi i Financimit të Terrorizmit	Këshilli i Evropës	Francë	19-22.12.2022	1
21.	Traktati Ndërkombëtar për shkëmbimin e të Dhënave për Verifikimin dhe Deklarimin e Pasurisë	RAI	Mali i Zi	20.12.2022	2
22.	Analizimi, diskutimi dhe testimi të sistemit për menaxhimin e të dhënave të Agjencisë-Modulet për deklarimin e pasurisë	SAEK III UNDP	Istog	22-24.12.2022	15